



Nga:
Bashkim Qeli

**Brigada e
XIX sulmu-
ese 1944-
30 gusht
2024**

fq. 7

Flet Gentjan Qejvanaj: Nismën për të udhëtuar me biçikletë nga Pekini në Kallarë e mora për të treguar vitalitetin e shqiptarit
Fjalë e dhënë, premtim i mbajtur. Gentian Qejvanaj përfundoi aventurën me biçikletë Kinë - Kallarë - Vlorë
Nga: Besnik Gjonbrataj



fq. 8-9

**Mirëse-
erdhët
në
Fterrën
e bukur**



fq. 15



LABËRIA



Periodike e Pavarur
Viti i XXIV i botimit Nr.180 (384)

Gazetë e Shoqatës Kulturore-Atdhetare "Labëria"

Shtator 2024
Çmimi: 20 lekë/ 1 euro

Piqerasi i dy heronjve të famshëm, Mitro Xhanin e Vasil Llaçin dhe nostalgjia për "Ullirin e Lotëve!"

INTERVISTA

Flet piktori Edmond Kojani: Paraviteve 1990janë vlerësuar pikturat "Nënat dhe gratë që shkojnë ndihmë te partizanët" apo "Ikja e rusëve nga baza e Vlorës"

Veçoj pikturat e Sali Shijakut "Zjarri partizan", Skënder Kamberit, "Në Vjenë duke parë Skënderbenë", "Bajram Curri" i Guri Madhit, "Gjyqi i Sinjës" i Vilson Kiliçës

Intervistoi: **Albert Z. ZHOLI**

Me Edmondin kam mëse 10 vjet që njihem dhe vazhdimisht ndjek pikturat e reja që ai sjell nëpër ekspozita kolektive, apo individuale. Një njeri i dashur, që gjithë jetën

Edmond Kojani




e ka lidhur me pikturën. Në Vlorë dhe më tej ai njihet si një piktor me vlera. Ai është një ndër piktorët e paktë shqiptar që ka hapur ekspozitë qysh në sistemin socialist. Vlorë i ka dhënë atij aromën e detit për një ideim dhe forcë interpretuese krejt të ndryshme...


fq. 13



Piqeras, Manastiri & Plazhi Bunec



Mitro Xhani, Hero i Popullit



Vasil Llaçi, Hero i Popullit

VËZHGIM

Vajza është stolisur si nuse Labërie



Nga: **Agim Çiraku**
Kryetar i Shoqatës Labëria
"Nderi i Kombit"

fq. 2

OPINION

Dukati i gjakosur



Nga: **Prof. Dr. Ago Nezha**

fq. 3

PORTRET

Baxhul Merkaj dhe muza e tij mëngjeseve tek "Europa caffè"



Baxhul Merkaj

fq. 16



Nga: **Ahmet Demaj**

të vish një ditë me ne. Qëlloi që për të marrë pjesë në një aktivitet pikture te Hoteli i mikut tonë arkitektit ...

Puna është art, arti do kulturë

Sa të rrosh do dëgjosh dhe do mësoh. Kështu do ta konsideroja njohjen time me personazhin që na mbledh sot, z. Rahmi Dervishin. E kisha parë në disa aktivitete në galerinë e Arteve në Vlorë dhe për kureshtjen time pyeta kush është. Do ta njohësh më thanë dy miqtë e mi Edi Kojani, drejtor i galerisë dhe Ilirian Ali do



fq. 5

Vajza është stolisur si nuse Labërie



Nga: Agim Çiraku
Kryetar i Shoqatës Labëria
"Nderi i Kombit"

Të nderuar pjesëmarrës!

*Të nderuar drejtues
të Bashkisë |Selenicë!*

*Të nderuar drejtues të shoqatës
së fshatit Vajzë.*

*Të nderuar, miq, artistë, shkrimtarë,
deputetë, dhe ju që keni ardhur nga
Labëria dhe gjithë Shqipëria për këto tri
ditë feste.*

Sot si lab, si vlonjat dhe si Kryetar i Shoqatës Labëria "Nderi i Kombit" ndihem i vlerësuar dhe i nderuar që marr pjesë në një festë të tillë. Ndhem i mrekulluar dhe i befasuart pasi, kur miku im, tashmë i mirënjohuri i Drejtësisë, z. Sokol Sadushi më dërgoi ftesën dhe pashë programin ngela i befatur. Tri ditë festë në një fshat të vogël. Tri ditë festë me një program të ngjeshur artistik me shfaqje të filmave artistik e dokumentar, një shfaqje teatrore biseda me aktorë e regjizorët, recitime të disa poezive të Ali Asllanit, ekspozime të pikturave të disa piktorëve vlonjat, këngë polifonike të grupeve të fshatit, të zonës, si edhe të një grupi nga arbëreshët e Italisë, një shfaqje teatrore për fëmijë, etj, përbëjnë një ansambël ndërkombehtar që nuk mund ta organizojë asnjë parti, asnjë organizatë dhe asnjë shoqatë vecc ajo e Labërisë. Sa hyra në Vajzë më bëri përshtypje zbulimi i fshatit. Nga fillimi në fund dukesh sikur shikon një nuse të bukur Labërie në ditën e dasmës. Kjo tregon se tashmë është krijuar një traditë e mirë që në çdo fundgushti, Vajza e Vlorës, fshati i Ali Asllanit shndërrohet në një qendër të rëndësishme kulturore, artistike dhe turistike. Jashtë politizimeve e dashuruar me vendin, traditat, Vajza këto ditë ka në gjirin e saj dhe artistët më të mirë shqiptarë që do të kishte dëshirë ti kishte mes tyre cdo qytet apo fshat. Ndosht rrallë ti takosh dhe në Tiranë figura të tilla si Mevlan Shanaj, Yllka Mujo, Piro Milkani, Marjeta Ljarja, Ndrim Xhepa, Kristaq Skrami, Agron Dine, Edmond Kojani, Engjell Dine, Helidon Haliti. Jam munduar të lexoj shumë këto ditë për Vajzën. Një emër sa i bukur që të kujton bukurinë njerzore

dhe ripërtëritjen e jetës po aq legjenda e vendosjes së emrit. Por më shumë Vajza kujtohet e nderohet për njëzrit e saj, për diturinë, trimërinë, bujarinë dhe traditat e veccanta. "Fshati o fshati im i bukur, fshati im hane, hane, fshati që s'paska një të dytë, në këtë mavri jallane." Janë vargjet e të pavdekshmit Ali Asllani, djali i fshatit Vajzë që i ka shkruar vendlindjes, dhe fshati ia ka vënë portretin dhe poezinë në ballë të vendit. Kur lexon Ali Asllanin fshati Vajzë, të vjen parasysh fshati barikadave, rrëzë Beunit historik, në



Fshati i Vajzës ka dhënë edhe shumë ndihma në luftën e 1913-1914, si dhe ka strehuar një numër muhaxhirësh nga fshatrat e Kurveleshit. Populli i Vajzës ka meritë të veçantë për mbledhjen që u bë në Beun në Maj të vitit 1920. Në këtë mbledhje morën pjesë edhe patriotet nga Vajza si Rexhep Sulejmani, Kalo Veselaj, Muhamet Meska, Shako Nazaj e Sadik Brahimaj. Historia e Vajzës është e Artë. Nga gjiri i saj kanë dalë intelektualë që kanë lartësuar jo vetëm erin e saj por edhe të Labërisë dhe të Shqipërisë.

Vajza është fshati i 22 dëshmorëve si rrallë kush në Shqipëri. Në këtë vend trimat janë mëkuar me qumështin e nënës për atdhedashuri. Ndërtuar mbi dy mijë vjet me parë në shpatin perëndimor të malit të Beunit, fshatarët e Vajzës, bashkë me themelet i dhanë besën atdheut se do japin jetën për të.

malin "Tartar", ku në këto male mban të shënuar në historinë e vet ngjarje dhe data historike, bij që i kanë dhënë e lënë vepër e emër, jo vetëm këtij fshati, por edhe historisë së vendit... Ali Asllani dhe Perlat Rexhepi janë dy emrat që e kanë lartësuar shumë Vajzën por edhe Shqipërinë. Kalimtarët ndalin qëndrimin dhe marrin qëndrim nderimi përballë dy figurave të ndritura të Labërisë, Vlorës dhe të vendit, pendëartit; Ali Asllani dhe pushkëndriturit, Perlat Rexhepi. Vajza është fshati i 22 dëshmorëve si rrallë kush në Shqipëri. Në këtë vend trimat janë mëkuar me qumështin e nënës për atdhedashuri. Ndërtuar mbi dy mijë vjet me parë në shpatin perëndimor të malit të Beunit, fshatarët e Vajzës, bashkë me themelet i dhanë

besën atdheut se do japin jetën për të. Fshatarët e vajzës kanë marrë pjesë në



shumë luftime historike për mbrojtjen e Atdheut. Në luftën kundër grekëve në Kuç e Bolenë, kanë marrë pjesë mbi 15 vetë. Fshati i Vajzës ka dhënë edhe shumë ndihma në luftën e 1913-1914, si dhe ka strehuar një numër muhaxhirësh nga fshatrat e Kurveleshit. Populli i Vajzës ka meritë të veçantë për mbledhjen që u bë në Beun në Maj të vitit 1920. Në këtë mbledhje morën pjesë edhe patriotet nga Vajza si Rexhep Sulejmani, Kalo Veselaj, Muhamet Meska, Shako Nazaj e Sadik Brahimaj. Historia e Vajzës është e Artë. Nga gjiri i saj kanë dalë intelektualë që kanë lartësuar jo vetëm erin e saj por edhe të Labërisë dhe të Shqipërisë. Vetëm nga programi i këtyre tre ditëve shikon se si po i ruan traditat ky fshat magjik. Ruan kostumet popullore, këngën e famshme labe, gatimet tadicionale, veglat muzikore tradicionale, ruan gjuhën e bukur shqipe dhe flamurin kuq e zi... Ti gëzoni këto tri ditë feste miqtë e mi. Ju me këtë festë po i tregoni Labërisë dhe Shqipërisë se aty ku ka vullnet të mirë, ku ka dëshirë të mirë, ku ka organizim të mirë, mund të ndërtohen ura lidhëse që forcojnë atdhedashurinë dhe ruajnë traditat e të parëve tanë. Edhe njëherë gëzuar dhe vazhdoftë në shekuj kjo traditë e shkëlqyer.

DUKATI I I GJAKOSUR



Nga: Prof. Dr. Ago Nezha

Historikisht, nga koha e monizmit dhe deri në këto 32 vjet të ashtuquajtura demokraci, pushtetet paradë kanë përdorur trysni, presione e dhunë daj banorëve të Dukatit, për interesa diktuese të klaneve pushtetare. Ky denigrim vjen për dy arsye subjektive:

që rrjedhin ose nga lakmia që kanë për vetë pozicionin demografik dhe orografik të vendndodhjes së Dukatit, me një sipërfaqe 260 km², me fusha, male e qendra turistike, e lagur nga dy dete, (deti Adriatik dhe deti Jon), ose për karakterin stoik, burrëror, identitar të banorëve të zonës, që nuk përulen e nënshtrohen pushtetarëve, se kanë qenë zot në pronat e tyre. Mesa duket kjo është leva e Arkimedit, që i ka xhelozuar dhe vazhdon t'i xhelozojë "kalorësit" e pushtetit. Dukati tradicionalisht ka qenë nacionalist, duke jetuar në trojet e veta dhe për asnjë rast nuk ka

të parët e tyre i kanë blerë me flori. Ky ritual i urisë gllabëruese të resurseve të Dukatit, vazhdon edhe sot, e papritmas na u shfaq më datën 25 Korrik, ku një grup banorësh nga Dukati protestuan se po ju marrin dhe ujin, që e kanë të kufizuar, por s'duan të dinë oligarkët e "borgjezisë" së re okulte. Vetëm ajrin nuk e pushtojnë dhe nuk j'ua mohojnë dot. Është krim ordiner, që edhe pas 32 vjetësh të ashtuquajtur demokraci veprojnë banda grabitqare, që të marrin jo vetëm pronat, por dhe resurset natyrore dhe kërkojnë t'i asfikësojnë, izolojnë e përdhunojnë në banesat e tyre. Këta aventurier të "borgjezisë së re", vertikalisht dhe horizontalisht, gjejnë



moderne, u ngjit rrugës së bardhë për në Llogora, ku qëndroi e pushoi dhe mori takim me përfaqësues të fshatit Dukat. Toponimet popullore e përligjin këtë veprim, pasi fshatarët qafën e Llogorait e quajnë "Qafa e Çezarit". Ai do kalonte nëpër Dukat për të mbritur në Orikum dhe për këtë fakt takoi pleqësinë e fshatit, ku bëri marrëveshje për të kaluar me ushtrinë e tij. Ata ranë dakord me dy kushte, që të mos shkatërrojë të mbjellat dhe bagëtitë. Me këtë marrëveshje, Çezari msyu drejt Orikumit. Ndërsa sot, në të ashtuquajturën demokraci liberale,



shoqëror, që janë gjakosur me të huajt, por jo t'i gjakosin vëllezërit e vetë, aventurierët, grabitqarët e kompromesaxhijë e pistë që bëjnë "orgji" me oligarkët, që tundin flamurin e "demokracisë". Ky veprim i shëmëtuar, më ka shkaktuar një frakturë të tmerrshme shpirtërore dhe psikologjike, që e përjetoj keq. Fraktura të tilla shkakëtohen në sisteme diktatoriale dhe jo në sisteme demokratike. "E keqja e demokracisë është se ajo na detyron të dëgjojmë edhe mendimin e budallenjve", shkruan George Bernard Shaw. Të gjithë grabitqarët aventurierë, duhet t'i bëjnë mirë llogaritë, se nuk do dalin të fituar nga ky veprim banditesk. Është për të ardhur keq, që në territorin e Dukatit veprohet në mënyrë arbitrare, duke shkëlur te drejtën e pronës apo dhe të banesës. Shteti për nevoja publike, siç është rasti i rrugës së Dukatit, mund të prek territore e prona private, të prishi pemtore e banesa, por paraprakisht duhet të negocjojë me pronarët legjitim dhe t'i dëmshpërblejë ata, për çdo ndërhyrje e cenim të pronës. Këto veprime banditeske, të kujtojnë qeveri xhunglash, që veprojnë si hordhi mbi një komunitet të caktuar. Po të shkojmë larg në histori, të gjithë e dinë luftën e Çezarit me Pompeun në Orikum. Çezari pasi zbriti në Palasë me ushtrinë e tij

Historikisht, nga koha e monizmit dhe deri në këto 32 vjet të ashtuquajtura demokraci, pushtetet paradë kanë përdorur trysni, presione e dhunë daj banorëve të Dukatit, për interesa diktuese të klaneve pushtetare. Ky denigrim vjen për dy arsye subjektive: që rrjedhin ose nga lakmia që kanë për vetë pozicionin demografik dhe orografik të vendndodhjes së Dukatit, me një sipërfaqe 260 km², me fusha, male e qendra turistike, e lagur nga dy dete, (deti Adriatik dhe deti Jon).

cenuar lirinë dhe të drejtat e askujt dhe për rrjedhojë nuk ka lejuar që të cenohen interesat vetiake. Për këtë krenari legjitime është penalizuar, paragjykuar, dënuar, ndëshkuar e denigruar në vitet e monizmit si antisistem, antikomunist. Ky qëndrim injorues, është shfaqur dhe në vitet e pseudodemokracisë, që i është mohuar prona dhe liria për të lëvizur e administruar pronat e veta nga Gadishulli i Karaburunit deri në Llogora. S'është e largët dita për të kujtuar rezistencën e djemve të Dukatit, që protestuan dhe u përgjakën me forcat e rendit për të vetmin "krim", se kërkonin pronat e tyre, që ua mohoi ligji fatkeq 7501, kur

Dukati tradicionalisht ka qenë nacionalist, duke jetuar në trojet e veta dhe për asnjë rast nuk ka cenuar lirinë dhe të drejtat e askujt dhe për rrjedhojë nuk ka lejuar që të cenohen interesat vetiake. Për këtë krenari legjitime është penalizuar, paragjykuar, dënuar, ndëshkuar e denigruar në vitet e monizmit si antisistem, antikomunist.

teren dhe te përfaqësues të pushtetit vendor, apo të komunitetit dukatas, që shiten ndyrësisht për ndonjë kockë, që u ofrojnë matrapazët politik dhe ekonomik. Ndihej i fyer, e i revoltuar si bir i këtij fshati emërmadh, me histori në luftërat për liri, pavarësi, çlirim kombëtar e

është ironi kur kujton se si vepron shteti me qytetarët e vetë, në mënyrë krejt arbitrare, pa marrë pëlqimin e pronarit. Si intelektual dhe qytetar i këtij komuniteti, i bëj thirrje klanit që ka nisur këtë aventurë të paprecedent, që të tregojnë mënjuri, qetësi e maturi, se nuk do dalin të fituar, me një veprim banditesk. Ndërsa komunitetit të ndershëm të Dukatit dhe përfaqësuesve të tij, do t'ju kujtoja thirrjen e poetit amerikan Wollt Uitman, që u drejtohej qyteteve ndërshtete me këto fjalë: "Kundërshtoni shumë e binduni pak, se bindja e thellë të çon në robëri të plot dhe prej robërisë së plot asnjë vend nuk ka dalë dot".

BRIGATA E XIX SULMUESE

1944 -- 30 Gusht -- 2024



Nga: Bashkim Qeli

Dhe pse vitet rrjedhin si lumi, dhe u largohen datave të fillesave, të ngjarjeve madhore aq më të vlefshme dhe të rëndësishme bëhen vetë ngjarjet! E pohojë këtë të vërtet duke parë tërësin e tyre, si në kohën e zhvillimit dhe të rëndësisë, ashtu edhe në pikëpamjen të vlerave që përçojnë në vazhdimësi historike. Konferenca e Parë e Vendit e PKSH (17 – 22 mars 1943), i kushtoi një vëmendje të veçantë, vënies në jetë të një prej detyrave të strategjisë së saj, për të luftuar kundër pushtuesit, krijimin e UNÇSH-së, si kusht i domosdoshëm për shndrimin e luftës në kryengritje të përgjithshme të armatosur, për çlirimin e vendit. Për këtë Konferenca orientoi: - “Të krijojmë prej njesive partizane vullnetare Ushtrinë Nacionalçlirimtare, të rregullt, e cila do të jetë fuqia e tëmershme kundër okupatorit dhe garancia e sigurt dhe e fuqishme për çlirimin e popullit.” (PPSH Dok. Kryes. Vëll.I f. 141) Në verën e vitit 1943, me përmasat që kishte marrë Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, ishin pjekur të gjitha kushtet për zbatimin e kësaj detyre.

Rritja e ushtrisë nacinoalçlirimtare u bë në mënyrë graduale, shkallë- shkallë, nga njësitet guerile deri në korparamata. E cila kaloi në tre faza, gjatë së cilave u zhvillua LANÇ-i.

Faza e parë (nëntor 1941 – korrik 1943), përkon me krijimin e njësiteve guerile, çetave dhe bataloneve partizane, me mbi 10 000 luftëtarë të tjerë të organizuar në 22 batalione dhe çeta parizane dhe mbi 20 000 luftëtarë të organizuara në çetat vullnetare territoriale.

Faza e dytë (korrik 1943 – maj 1944), që përkon me Krijimin e SHP dhe brigadave sulmuese dhe krijimi ZIO Vlorë - Gjirokastrë dhe shtabete qarqeve, e cila në fund të fazës së dytë u kthye në ushtri të rregullt partizane me një efektiv mbi 35 000 partizanë të inkuadruar në Brigadat 1,2,3,4,5, 6, 7, 8,12, Sulmuese, në 10 grupe partizane dhe 14 batalione autonome, pa llogaritur çetat batalionet vullnetare.

Faza e tretë (maj- nëntor 1944), ku ushtria partizane kaloi në shkallën më të lartë në ushtri të rregullt, me krijimin e KP UNÇSH-së, ku u krijuan 8 divizione dhe tre korparamata, me një efektiv 70 000 partizanësh. Lufta antifashiste nacionalçlirimtare ishte zgjeruar shumë, e si rrjedhojë u krijuan divizionet dhe krahinat e Shqipërisë së Jugut, ishin çliruar plotësisht forcat armike mbanin disa qytete. UNÇSH -ia, kishte marrë nismën operatrive dhe kishte kaluar në mësymje të përgjithshme, DIS kaloi lumin Shkumbin për çlirimin e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, ndërsa forcat e tjera kaluan në sulm për çlirimin e qyteteve të jugut. Gjatë kësaj faze krijohet edhe Br 19 S në Theollogo të Gjirokastrës, më 30 gusht 1944. Ajo u formua mbi bazën e Grupit IV

partizanë, “Çamëria” i ZIO, që kishte kryer veprime luftarake në zonën e Konispolit, Sarandë, Dropull dhe gjatë bregdetit Sarandë – Himarë. Megjithëse brigada ishte e re efektivi i saj kishte një përvojë të pasur luftarake. Efektivi i saj përbëhej nga fshatrat e Konispolit, Dropullit, Vurgut, dhe Pogonit. Kjo brigadë u quajt si brigada e Vlazërimit midis popullit shqiptar dhe atij minoritar. Formimi i kësaj brigade ishte një ngjarje e rëndësishme për popullin dhe ushtrinë nacionalçlirimtare veçanërisht për popullin e zonës ku u krijua. Baza e formimit të brigadës ishte Gr. IV P “Çamëri” i ZIO, i përbërë nga batalionet “Thoma Lulo”, b1P, “Thanas Ziko” b2p, dhe “Lefter Talo, b3p, dhe batalioni “Mateoti” në përbërje të saj ajo kishte dhe një kompani mortajash 81 m/m, me një efektiv 850 vetë ku 65 prej tyre ishin vajza. Kalimi nga grupi partizanë në Br 19 S ishte një rritje e përsosje nga ana e strukturës organizative. Në brigadë militonin 130 komunistë të organizuar në 31 celula partie. Në brigadë dhe në batalion kishte përgjegjësi rinie, ndërsa në kompani kishte aktiv të rinisë, në brigadë ishin 410 të rinjë. Në brigadë dhe batalion kishte intendent për prapavijën, që siguronin furnizimin me ushqim, veshmbathje dhe municion. Krahas shërbimit të prapavijës u organizua më vonë shërbimi shëndetsor. Në Theollogo ishte ngritur edhe spitali partizan në Leshnicën e Sipërme, çdo batalion dhe kompani kishte infermier me çantën sanitare. Baza për funizimin me ushqim e veshmbathje ishte populli i zonës. Struktura organizative e Br19S ishte, Komanda e Shtabi i brigadës, Seksioni Politik, Sektori i prapavijës, sektori shëndetsor, Artileria, sektori i ndërlihdjes dhe kompania e shtabit. Komandant Brigade Andrea Nasi, dhe më vonë Thoma Xhixho, Komisar brigade Vango Mitrojorgji e Thoma Xhixho, Përgjegjës rinie Niko Papa, intendent brigade Jasin Kseno. Komandantët batalioneve ishin Edip Çuçi, Panajot Pano, Kosta Vatovali, Vasil Dalani, Miltiadh Papa e Kristofot Mullaji. Komisar batalionesh ishin Polo Bezhani, Thoma Xhixho, Theodhori Shano, Vango Mitrojorgji, Kosta Katranxha, Jorgo Koço. Armatimi i brigadës kryesisht ishte armatimi i lehtë armët e këmbësorisë, çdo batalion kishte 4 mitralozë të rëndë Italian dhe gjerman. Batalionet e kësaj brigade dhe ato përpara formimit të saj, duke zbatuar direktivën e PKSH dhe udhëzimet e SHP dhe më pas të KP të UNÇSH-së Enver Hoxha, kanë bashkëveprura ngushte me forcat greke të EAMI –it për asgjësimin e armikut të përbashkët të cilat mundësuan për vllazërimin e dy popujve shqiptar dhe grek. Me gjithëse prurimi i Brigadës 19 S, u bë më 30 gusht 1944, rruga luftarake e saj kishte filluar qysh herët kundër pushtuesëve dhe tradhëtraëve të vendit. Më 18 qershor 1943, mbi bazën e çetës partizanë “Çamëria”, në Pandalejmon të Konispolit, u krijua batalioni partizan “Çamër”, i cili, për një periudhë një mujore

BRIGADA
XIX
SULMUESE



ariti efektivin 220 partizanësh, i përbërë nga tre çeta “Alush Taka”, “Hoxha Tasim” dhe “At Stath Melani”. Batalioni me bazë çete kreu veprime luftarake në afërsi të Urës së Kranes, në luftën e Kuqarit në Përmet, dhe mbrojtjen e Konispolit. Batalioni “Çamëria” në bashkëveprimi me forcat territorial të Konispolit, Vervës, Mursisë, Pandalejmonit, Shalësit, Vagalatit, Markatit, Sopikut, mbrojtën me sukses Konispolin duke thyer suletet e forcave

Br19S morri për detyrë që të sulmonte Konispolin në bashkëveprim me forcat Br8S dhe regjimetin e 15 të EAM-it. Sulmi filloi në ora 09.00 të 28.08. dhe mbas lufimesh të ashpra forcat e Br19, 8 S u futën në Konispol. Me çlirimin e Konispolit rruga Konispol – Delvinë u vu plotësisht nën kontroll nga forcat e Br19 S. Detyre tjetër për forca e Br19S ishte mbajtja nën goditje rrugëkalimin Sarand- Delvinë- Jorgucat- Kakavijë, duke vepruar me grupe të vogla godiste kolonat armike në këtë rrugëkalim.

gjermane që vinin nga Filati e Preveza. Më 5 nëntor 1943, mbi bazën e batalionit “Çamëria” formohet Gr 4 P “Çamëria” i ZIO me komandant Jaho Gjolligju dhe komisar Mustafa Matohit, më 26 nëntor grupi iu shtua edhe batalioni “Thanas Ziko” i formuar në Dervicën të Dropullit dhe në dhjetor në fshatin Markat të Konispolit u formua batalionet “Telo Plaku” dhe “Pandeli Boçari” të cilët u futën në përbërje të Gr4 P. Me dështimin e Operacionit armik të qershorit 1944, pushtuesi u vu përpara një dështimi të madh, sepse nuk i realizuan objektivat për likuidimin e forcave parizane në jug të Shqipërisë. Për forcat partizane u krijuan kushte të favorshme për të realizuar urdhërin e KP të UNÇSH-së Enver Hoxha të 28 gushtit 1944, drejtuar ZIO, ku thuhej: -“ Forcat duhet të jenë gati, që në urdhërin e parë të sulmojnë qytetet. Urdhërat që merrni dhe ato që jepni të zbatohen më ashpërsinë më të madhe. Kush shmanget ka përgjegjësi të madhe. Lidhjet ndërmjet reparteve të jenë të forta dhe të shpejta.” (Dok. KP e SHP vell.2.f. 130-131) Në fund të verës së 1944, forcat e UNÇSH-së ishin hedhur në sulm për çlirimin e vendit. Br19S

morri për detyrë që të sulmonte Konispolin në bashkëveprim me forcat Br8S dhe regjimetin e 15 të EAM-it. Sulmi filloi në ora 09.00 të 28.08. dhe mbas lufimesh të ashpra forcat e Br19, 8 S u futën në Konispol. Me çlirimin e Konispolit rruga Konispol – Delvinë u vu plotësisht nën kontroll nga forcat e Br19 S. Detyre tjetër për forca e Br19S ishte mbajtja nën goditje rrugëkalimin Sarand- Delvinë- Jorgucat- Kakavijë, duke vepruar me grupe të vogla godiste kolonat armike në këtë rrugëkalim. Ndërsa për në drejtimi të Sarandës forcat Br19S u shtrinë veprimet deri në fshatarat

Vromero- Çukë. Nga 10 -15 shtator forcat e b2p të brigadës kryen një sërë goditjesh në rrugëkalimin Jorgucat - Delvina.

Në pesëmbëdhjetëditëshin e parë të muajit shtatorit, Br19S morri për detyrë që në bashkëveprimi me Br14 S të çlironin Gjirokastrën. Me një batalion, gjatë datë 15-16 shtator organizoi pritë në rrugëkalimin Gjirokastrë – Janinë, në rajonin Dhruvjan-

Sofratik-Terihat dhe Gornxi-Vanistë, por nuk pati asnjë lëvizje nga armiku. Sulmi filloi në mbasditë të 17 shtatorit. Armiku duke e ndjerë rrezikun në agim të 18 shtatorit u largua nga Gjirokastra. Populli i Gjirokastrës i priti me krahhapur dhe entuzizëm partizanët që çliruan qytetin e tyre. Më pas shtabi i Br19S mori për detyrë që të godisnin forcat gjermane në Delvinë dhe Sarandë dhe t'i çlironin ato.

Për çlirimin e Sarandës forcat e brigadës bashkëvepruan me forcat angleze të cilat do t'i mbështesnin me zjarrin e artlerisë nga deti. Sulmi për çlirimin e Sarandës u bë i befasishëm dhe i shpejt nën mbështetjen e artilerisë së anijeve nga deti dhe mbas tre ditë luftimesh forcat armike u asgjësuan dhe u çlirua Saranda.

Me çlirimin e Sarandës brigade morri detyrë që të çlironte Delvinën. Më 9 tetor 1944, b1p i Br19S kishte zënë pozicionin në lartësit e fshatit Kostar- Mukres- Xhermehall lagje në periferi të Delvinës.

Artileria angleze hapi zjarrë mbi fshatin Vromero dhe Halite ndërsa forcat b1p të Br19S hapën zjarrë të fuqishëm, nën trysnin e forcave partizane më 8 tetor forcat gjermane braktisën Delvinën dhe më 9 tetor forcat e b1p u futën në qytetin e çliruar të cilat u pritën me dashur dhe entuziazëm nga qytetarët e Delvinës Me 10 tetor 1944 KP e UNÇSH-së me urdhërin nr.378, ku thuhej: -“ Për të nkësuar veprimet e brigadave tona dhe për ta bërë më të fuqishme goditjen kundër okupatorit gjerman dhe tradhëtarëve të vendit, urdhërojmë, formimin e D 3 S, i cil do të përmbledh në gjirin e vet, Br 12, 14, 19 S.” (Dok.KP e SH tëUNÇSH-së vell.2.f.243). Me çlirimin e Delvinës KP e SHP i UNÇSH-së vuri në gatshmëri forcat e Br 12, 14, 19 S për të mbrojtur bregdetin dhe rajonet kyçe si Qafa e Gjashtë, Butrintin.Bogazin.

Me çlirimin e Sarandës Br19 S morri në dorzim qytetin ku u vendos Shtabi brigadës dhe b3p në Sarandë, b1p morri urdhër të marshonte për në Himarë dhe të vendosej në Vlorë, bp “Metoiti” u vendos në Delvinë dhe b2p u vendos në Konispol. Me detyrë që të mbronin bregdetin shqiptar Saranda - Himar e Vlorë.

PUNA ËSHTË ART, ARTI DO KULTURË



Nga: Ahmet Demaj

Sa të rrosh do dëgjosh dhe do mësosh. Kështu do ta konsideroja njohjen time me personazhin që na mbledh sot, z. Rahmi Dervishin. E kisha parë në disa aktivitete në galerinë e Arteve në Vlorë dhe për kureshtjen time pyeta kush është. Do ta njohësh më thanë dy miqt e mi Edi Kojani, drejtor i galerisë dhe Ilirian Ali do të vish një ditë me ne. Qëlloi që për të marrë pjesë në një aktivitet pikturë te Hoteli i mikut tonë arkitektit Piro Stefa, në kthim një kafe e pimë të kjo vilë. Hyra pak në bisedë por mësova shumë se çfarë mund të arrij një njeri që do punën, që guxon të ketë një fillim të ri, që të mos ndiej lodhje të moshës, që të mos lakmoj atë që nuk është e tija, por të krijoj një model që të tjerët ta ndjekin në shembullin që jep.

E kujton babain e tij Veli Resul Dervishaj, kryeveteriner në Kom. Ekz. nga i cili mori edukatën e punës.

Që 15 vjeç filloi të punonte Ramiu mbas njerzve të tij si murator. Mbas detyrimit ushtarak për 40 vjet shofer në Parkun e Mallrave. Dhe kur dëgjon me vëmendje shkëpuste një shifër, në 365 që kishte viti 225 ditë në shoferët zgjuheshim në orën 400 të mëngjezit. Don të thotë me këtë, që ishte sakrifikuës jo vetëm për vete, por edhe për familjen e tij, kujdesi për fëmijët, vështirësi që janë të profesionit.

Punuam por dhe u nderuam për punën e mirë. Punuam dhe rritëm fëmijët, mbajtëm familjen shokët dhe miqt, sot vuajmë për këta elementë.

Edhe tani punojmë por na kanë lëvizur ca gjëra thot me humorin e tij të zakonshëm. Sidoqoftë: ajo që u bë shkak që ne të jemi këtu është përvoja që na jep jeta e një njeriu të thjeshtë, që kënaqësinë dhe pozitivitetin e tij e gjen te puna e ndershme dhe vizioni i tij të përshtatur me kohën. Tek kjo rrëpirë asnjëri nuk do t'i shkente mendja se mund të transformohej në një zhvillim kaq të bukur, kaq të sukseshëm. Ramiut po. Me syrin e tij të mprehtë, me besimin te forcat e tij fizike dhe mendore, te përvoja për ndryshim, te mbështetja e tërë familjes filloi: Për ata që s'e njohin le të më dëgjojnë dhe të mësojnë se çdo e mirë ka një fillim dhe çdo fillim ka një

(Mësim nga jeta e një puntori)

fund. Fundi atij fillimi të vështrë që dukej kur Ramiu me vare e me qysti, me kazëm e me lopatë, me çekiç e me mistri, gurë pas guri, ledh pas ledhi, dhomë pas dhomë, arriti këtu. Ndërtoi një biznes fitimprurës për familjen. Ky biznes i ndërtuar komplet

dhe vizaton, bën piktorin jo për nam, jo për fitim, por për të shprehur qendrim ndaj të bukurës që çfaq natyra në bregdet. Edhe po të ishte në mal pranë kërrabës do kishte penelin. Do ta shikojmë ekspozitën e tij dhe do të themi se tre ekspozitat e tij të



me forcat e veta i ndryshoi jetën dhe e drejtoi drejt asaj që ne e quajmë model në ekonominë e tregut. (punësoi 10, pret 40 puntorë ditor, javorë), dhe bashkë me fëmijët, bashkëshorten, punëtorët dhe pushuesit Ramiu i quan pjesë e familjes së tij. Dhe ky qendrim për mua është çelësi i suksesit. Çdo pushues ka 5 m2 gjerlbërim, ka 5 m2 plazh, ka ajrin e pastër, fushëpamjen pa mbarim mbi detin dhe Sazanin, ka qetësinë dhe sigurinë, falë mikëpritjes së tij. E kam pyetur se kë ka pas projektues, zbatues, arkitekt ndërtimi, gjelbërimi, mobilimi? Vetë thotë shih terrenin dhe gjyko më të mirën, konsultohem me Perëndinë të mos më mësoj keq dhe të më heq nepsin: Pse të tjerët kanë më shumë. Kam plot bile dhe më tepron të jap ndihma te ata që kanë nevojë apo siç dhash kontribute për tërmetin e para disa vjetëve në Durrës.

Nuk hyj në jetën e fëmijve. Le ta kuptojnë vet në u bëhet mirë andej të vazhdojnë në se kanë mendjen time ja ku mund të zhvillohen në vendin e tyre. Ne vlonjatët thonë shakaxhit, kur nuk ke bisht ta vendosin, kur e ke ta presin. Gjetei vendin thonë ca për Ramiun.

Jo them unë që avash avash po njoh karakterin e tij. Edhe në mal po të ngulej Ramiu do të bënte gjëra ndofta edhe më të bukura se këtu. Ai ka mendje dhe e lodh atë në favore zhvillimi: u shmang nga dominoja, nga rakia, nga llafet e thashethemet dhe u muar me punë. Po kohë të lirë a ka ky njeri? Po por mësoni si e kalon Ramiu kohën për tu çlodhur? Merr penelën, furçat, lapsat me ngjyra

Kjo na bëri që në emër të SH. A. K. "Labëria" t'i sjellim sot bashkë me dy miqt e mi, Namik Jahaj dhe Albert Habazaj Çerifikatën "Mirënjohje e Labërisë". Entuziazmi u shpreh me duartrokitje shumë të sinqerta. Dy gazetarët Ermal Sika dhe Algert Harizi pasqyruan bukur çdo skenë dhe fjalë të këtij aktiviteti. Domosdo piktori i Vlorës Edi Kojani zbërtheu në detaje mbas heqjes së perdes ekspozitën e RAMI DERVISHIT. Gati 30 piktura të sajuara dhe kuruar bukur në përshtatje me buzëdetin e Vilës Dervishaj. Shkëputa nga fjala e tij. Sado të veçant që ka piktura e këtij vlonjati, ajo i nënshtrohet bukurisë dhe traditës që ka shkolla e pikturës vlonjate. Ramiu është në kërkim të së resë. Atë e gjen te peisazhi i mbrëmjes apo te dielli i mëngjezit. Arti është punë, por do kulturë.

Alberti theksoi: Nuk më befason piktura e Ramiut me të cilën jam njohur edhe herë të tjera. I befason mbeta nga



hapura janë produkt që Rami Dervishi pa shkollë pikturë konkuron denjësisht për të krijuar pikturën amatore, që ndonjëherë është aq konkruuese sa edhe piktura profesionale. Dhe për Vlorën kjo është një lloj trashgimnie dhe traditë e mirë.

Pa ju lodhur do t'ju tregoj një episod: këngëtari italian Albano Karizi erdhi në Vlorë për një koncert. Kisha lexuar librin e tij në kohën e lirë se çfarë bënte me duart e tij (mure, taraca, vreshta, verë etj).

Ndaj kur më erdhi rasti për doli theksova: Një doli për shëndetin e tij si këngëtar por më shumë edhe për kallot në duart e tij që na të mësojmë, si dhe pse të dashurojmë punën. E quajti komplimentin më të madh që ju bë. Sot maso nuk është shumë e goditur, por ju kërkoni një duartrokitje për Ramiun jo për kallot në duart e Ramiut, por për penelin dhe dashurinë e tij për artin në përgjithësi dhe pikturën në veçanti.

ambjenti i ndërtuar me kaq kulturë. I uroj suksese. Ilirian Ali aktor deklaroi: të vlerësosh artin gjë e zakonshme, por të vlersosh atë që bën arti kjo merr dy herë vlerë. Piktura e tij është poezi të frymzon shpirtin të shprehesh. Kur do njeriu gjen. Ju të Labërisë evidentoni personazhe që të prekin në ndjenja. Ju lumtë.

Petra Pali: Kam ardh jo vetëm si njeri i Artit por edhe si mik i Ramiut prej 40 vjetësh. Shumë të tjerë midis tyre Irfan Bilbili si mik familjar i Ramiut ngriti vlerat e personazhit të të organizatorëve. Kryeplaku i Vunoit foli pak por tha fjalë të mençura. Ashtu si dhe shumë të tjerë. Vajza e Ramiut në emër të familjes emocionoi të pranishmit. Punën e të jatit e quajti shkollë për gjithë pasardhësit e tij. Vet Ramiu u emocionua kur mori dekoratën dhe e quajti këtë moment nderimi. Ditë të veçantë të jetës së tij. Kënga dhe gëzimi i asaj dite do mbahet mend gjatë.



SHOQËRIA NJERËZORE KA NEVOJË PËR NJERËZ TË MIRË



Nga: Ilirjan Ballaj

Shoqëria njerëzore ka nevojë për njerëz të mirë, e të tillë sipas Makiavelit janë ata që kanë ide të mira dhe i realizojnë ato. Mirësia është rezultante e meritës personale plus kushteve prej nga vjen e ku vepron individi. Ky është koncepti dialektik për mirësinë. Një ndër njerëzit e mirë është edhe Ahmet Demaj, kryetari i Shoqatës Labëria dega Vlorë, funksion të cilin ka kohë që e mban, që prej 2011 e që besoj se do të ketë kohë që ta mbajë falë mirësisë së tij dhe kohezionit që mbart për t'i bërë njerëzit bashkë, madje të gjithë. Po shkurt, kush është Ahmet Demaj?

Ai ka lindur më 23 mars 1947 në një truall të shëndetshëm njerëzish me vlera atdhetarie, në Velçën e Vlorës, në Velçën e patriotit Selam Hasani që me Mahmud bej Vlorën e trima të Labërisë bënë Luftën për trojet çame të 1854, që e vendosën kufirin me grekun në Artë, ku do të dëshironim ta kishim edhe sot, e “u vra për veten e tija”, në Velçën e mësuesit patriot që kontribuoi në hapjen e shkollave shqipe pas 1908, Yzeir Skëndo, të patriotëve Veiz Brahimë e Ali Beqiri të 1920-ës, të burrave të tjerë trima e të mençur të mëvonshëm që luftuan për lirinë e punuan për kombin, ai është po aq edhe nga Velça mitike, epike, vizive dhe e vlerave të mëdha natyrore e arkeologjike, e njerëzve të punës. Është bir i një familjeje atdhetare që luftës i ka thënë luftë për vatan, mikut mik e bukës bukë.

Kreu shkollën 7 vjeçare në vendlindje, të mesmen pedagogjike Tiranë dhe fakultetin biologji-kimi në Universitetin Luigj Gurakuqi Shkodër. Shërbeu në arsim në Tepelenë, Vlorë deri drejtor shkolle, gjatë. Për urtësinë e tij të dyfishtë njerëzore dhe intelektuale u zgjodh kryetar i Shoqatës Atdhetare Labëria dega Vlorë. Jemi një moshë, kemi të njëjtën linjë arsimimi madje edhe ish

Shoqëria e mirë bëhet nga njerëz të mirë e, kur të kalojnë kohët, njerëzit e mirë do të bëhen edhe pak mitikë, më të mëdhenj do të duken, atëhere do të shkruajnë brezat për dijen e mirësinë e tyre sikurse kemi shkruar ne për brezin e jataganit e të pushkës..Njerëzit idealistë gjithnjë i ka dashur koha, por kur idealizmi dhe mirësia bëhen bashkë më e fortë bëhet shoqëria. Ahmet Demaj, pa frikë, është një i tillë, idealist dhe i mirë, njeriu që i duhet shoqërisë.

mësues Tepelene, jemi nga dy fshatra që i ndan një lumë gjysmë i tharë në verë, por që edhe dimri nuk se i ka penguar për të shkruar te njëri-tjetri, edhe pse notin nuk e kanë zotëruar, e kanë kaluar atë lumë gjer në grykë kur e ka dashur gëzimi, hidhërimi a halli. Madje janë shumë vajza të shkuara

nuse te njëri-tjetri fshat që në kohë edhe pse thonë se dikur ato dy fshatra kanë qenë dy vëllezër, që u ndanë edhe me pak lojë e shaka me njëri-tjetrin. Thonë, se që të ndanin territoret, hipën natën të dy në dy male përballë, njëri në Tartar e tjetri Qeramëngë, e ndezi njëri zjarrin, e ndezi edhe tjetri dhe u nisën, aty ku u takuan vendosën kufirin që kanë edhe sot. Bashkimi më vonë në një kooperativë bujqësore i forcoi shumë, sepse njëra palë kishte malin kullotë e tjetra ujin e vaditjes. Velçotë janë dalluar për thjeshtësi, bujari e mirësi, për patriotizëm e dije. Pak kontakte kam patur me Ahmetin, përjashto një dreke te Shkëmbi “Nuri Dalani” në Vajzë një vit më parë në të cilin ishim disa krahinorë, ku përforcova tërë atë bindje që kisha se Ahmeti ishte burrë i mirë, i qetë, i avashëm, i thjeshtë, fliste me radhë e kur duhej, trajtonte probleme që duheshin trajtuar, kurrë nuk u lëvdua, kënd nuk shau, ai përcillte edhe shaka me dollinë e tij të këndshme dhe mu duk një burrë mitik. Ajo që mbizotëronte në karakterin e tij ishte urtësia e dyfishtë. Thonë se karakteri i njeriut ngjizet që shtatë breza më parë e Adn-ja e Ahmetit është e shëndetshme. Ai ka patur pasion mbledhjen e fjalëve të rralla nga visaret e kombit, ka botuar katër libra me tregime. Është i dekoruar me urdhërin “Naim Frashëri”, “Ambasador i paqes”, ka qenë anëtar i këshillit të qarkut Vlorë. Është gazetar i mirë, në gazetarinë e tij spikat aftësia



Një ndër njerëzit e mirë është edhe Ahmet Demaj, kryetari i Shoqatës Labëria dega Vlorë, funksion të cilin ka kohë që e mban, që prej 2011 e që besoj se do të ketë kohë që ta mbajë falë mirësisë së tij dhe kohezionit që mbart për t'i bërë njerëzit bashkë, madje të gjithë.



për të shkruar këndshëm madje edhe ndryshëm, me një stil pak Moikomian, që mendimet i parashtron në formë tezash, ideshë, është kritik i mirë, është polemist i arsyeshëm e racional. Ka shkruar për pavarësinë, për Luftën e Vlorës, për arsimdashësit vlonjatë, për dëshmorët, për shoqatat kulturo-atdhetare, për burra të dëgjuar labë e kryesisht Velçiotë, për kryegjyshin botëror sot që i nderon shpesh me vizitat e tij, ka shkruar deri edhe për rrugën disaveçare FED, 2014 ku shprehet se Vlorë ka uri për zhvillim. Rri shpesh në fund ndër tubime, por evidentohet për i

kulturën e heshtur që ekziston në Trevën e Labërisë, për figura të pazbardhura mjerisht luftëtarësh që i ka mbuluar mjegullnaja, për dëshmorë që ranë në luftën për liri që herë i qajnë e herë i shajnë, trajton probleme të zhvillimit dhe angazhohet vetë në zgjidhjen e tyre plotë urtësi e durim. Mban lidhje të ngushta me njerëzit. Në këtë pikë thuhet se është një etalon, ka shumë njerëz rreth vetes e gëzon simpatinë e të gjithëve. Ai është në pensionin modest të mësuesit, por punon se ia do shpirti, ia do formimi, njeh mirë gjithë krahinën Lumi i Vlorës dhe më tej, ka shumë miq e shokë akademikë, politikanë, udhëheqës shteti, punëtorë, barinj, mësues, nxënës e bisedon me ta duke zotëruar të gjitha regjistrat e komunikimit, si ato pilitiko-shoqëroro-administrativ edhe stilin e thjeshtë e familjarë, sikurse ia do puna. Ka një të qeshur të këndshme që e zotëron në komunikim, është nga ata burra për të cilët thuhet “ka pak fjalë e shumë punë”. Ai është njeriu i mirë që rrezaton që larg, ai është një verë që provohet në një gllënkë,

ai është një oaz që i shikon edhe zallin. Vullnetarizmi i tij është një tjetër virtyt për të. Shoqatat atdhetare gjithmonë kanë qenë jashtëqeveritare e jo partiake.

Të ketë njerëz të tillë shoqëria njerëzore është më e mirë, por mjerisht jo te të gjithë vitrina me magazinën janë një. E përse kohë do të kemi njerëz që fshehin atë që kanë ndënë lëkurë, do të na duhet të evidentojmë njerëzit e mirë si Ahmet Demaj i Vlorës. Shoqëria e mirë bëhet nga njerëz të mirë e, kur të kalojnë kohët, njerëzit e mirë do të bëhen edhe pak mitikë, më të mëdhenj do të duken, atëhere do të shkruajnë brezat për dijen e mirësinë e tyre sikurse kemi shkruar ne për brezin e jataganit e të pushkës..Njerëzit

parë në mendime, madje këtë ia kanë vënë re të tjerët dhe, në mënyrën më njerëzore e më shqiptare a labe, kanë përcjellë edhe ndonjë doli për të. E shprehja” hë më të pifsha dollinë” është për burrat e zotë e të mirë.

Jeton në Vlorë, por shpirtin e ka në fshat, në fshatin plot vlera njerëzore, dashurie, thjeshtësie, vullneti, vëmendjeje, urtësie. Ka hulumtuar mirë historinë e krahinës dhe të fshatit të tij dhe është kurajoz në ato që ka thënë si: për shpella prehistorike të Velçës, për

idealistë gjithnjë i ka dashur koha, por kur idealizmi dhe mirësia bëhen bashkë më e fortë bëhet shoqëria. Ahmet Demaj, pa frikë, është një i tillë, idealist dhe i mirë, njeriu që i duhet shoqërisë.



NË PIQERAS KU DETI, MIKPRITJA, AJRI I PASTËR, VIRGJËRIA E NATYRËS TË TUNDOJNË!

Piqerasi i dy heronjve të famshëm, Mitro Xhanin e Vasil Llaçin dhe nostalgjia për "Ullirin e Lotëve!"



Nga: Miho Gjini

Në pikun e tij, - është edhe thirrja "ejani në Piqeras pasi ata shumë intelektualë që e kanë vizituar e kanë quajtur Piqerasin si fshatin" më të bukurin në botë", po edhe "vëndin e gjelbër e pa viruse", ku nuk është e nevojshme asnjë karantinë gjatë Covid-19, në ajrin e aromat midis malit, lumit të egër të Bunecit dhe Detit Jon!

Edhe gjatë "vitit të maskave" këtu, thujse nuk viheshin ato, kur përmes ajrit qarkullonin vitaminat- C e D- që ndodhen në këtë zonë përjetësisht të gjelbër, me frutat Bio që vet banorët i kanë të klimës së tyre, mbjellë e rritur. Duke shtuar: pozicionin fantastik, si të një anijeje "të ankoruar" mbi kodër, të shtëpijave që gjarpërojnë në katër drejtime, fshehur nënë ullishtat shekullorë... deri në anëdetin e virgjër të Bunecit, ndarë nga ai lum jetëdhënës, i vogël dhe i egër, që gurgullon e shkumëzon që nga "këmbët e Sasaj" (fshati i vogël i Adriatik Kallullit të madh!), deri në Bregun e Detit, në limanin e hershëm që dikur u vinte në ndihmë me ujën e pijshëm që buronte nga mali, gjithë anijeve që lundronin Jonin, Adriatikon e Mesdheun.

Në disa dokumentare televizivë, realizuar me një vështrim artistësh të përkorë, nga ku nuk munda t'i krrejë gjithë emrat e autorëve, -ajo që fliste e para ishte natyra me hapësirën e saj, panorama dehëse, - ndofta për herë të parë e fiksuar nga lartë, që ta shohin edhe ata persona "më të lartë" që hartuan listën e "100 fshatrave turistike" e as që u shkoi mendja fare, për njerën nga "perlat" më të ndritshme të vëndit! Po janë edhe thëniet e atyre 200 turistëve që erdhën këtu parvjet e mbushën të tre hotelet e Bunecit, si edhe apartamentet e përgatitura për ta nga 15 familje piqerasiote, me bukë, krypë, zemër dhe magjinë e fshatit të tyre. "Faleminderit për gjithçka të bukur që kaluam aty, -na shkruajnë dy çifte nga Hollanda, -U kënaqem me panoramën fantastike dhe mikpritjen. Njerëzit në fshatin tuaj të mrekullueshëm janë fisnik, përballë një deti që relakson parreshtur me blunë e thellë, me diellin e ngrohtë, me rërën e imtë dhe me peshqit e shijshëm. Dhe ne do ta shprehim këtë kënaqësi

të rrallë në vëndin tonë!" (Me dashuri Savane, Jacob, Michael dhe Miranda, Zaandam. Holandë 19 korrik 2018).


Po ç' thotë vallë ai zyrtari ynë që "e la fshatin tonë pas liste"! Pa bërë investimet kryesore, pa ndrequr as Muzeun e Heronjve në qendër të fshatit (*mbetur si "relike" e barbarisë së 97-ës!*), pa shtruar rrugën me gunga e gropa" të plazhit të Bunecit e duke e lënë ende këtë anëdeti kurativ në "mundësitë primitive të Robinson Kruzosë të Defosë" (*me ndreq e prishë tenda e kasolle kashte!*). Po, a i shikojnë vallë edhe këto realizime kinematografike dhe të binden prej fjalëve, që thonë banorët e fshatit të këtushëm, ata të palëvizurit nga trualli i tyre, sikundër janë: Arsen Konomi, Katina e Vasil Gjivogli, Majlinda e Aristidh Ali, Luli e Spiro Gjezo, Emiljano Bitri e Andon Laska, Niko Nino e Nikolin Laska, Miho Nini etj, - të cilët shprehen me dhimbje edhe për ata që ikën nga halli dhe e braktisën fshatin e tyre, për dyert e mbyllura të fiksuara nga kamaremanët, për çatitë e muret e rëzuara të 70 shtëpive, po edhe me ngazëllimin e tyre për të kthyerit nga kurbeti, për shtëpiat e reja që u ngritën, si edhe për hapjen e dyerve të shtëpijave egzistuese të tyre për turistët e huaj. Dhe akoma për lulet! Për morinë e luleve që rrethonin Fabulistin Gjivogli në shtëpinë e tij fundore, tek fliste e pinte një gotë raki me gazetarin e këndshëm Eni Shehu, si një urim për këtë fshat fisnik, me emrin më bujar në botë: "PI (dhe) QERAS!" Po edhe për lulet e shumta të oborrit mbi Xhade, midis të cilave fliste Zonja Majlinda Ali, në atë shtëpi të ujditur me merak, së bashku me bashkëshortin aq shumë të lidhur me Piqerasin, Doktorin Pediatër, Aristidhin!



Piqeras, Manastiri & Plazhi Bunec

Duke vazhduar me një tjetër kameraman, që s'ia fiksova dot emrin, në një tjetër film, realizuar në shtëpinë e "majës së Hasit" të Spiro Gjezos, ku bashkëshortja Luli, ngjante si në një parcelë të Kopshtit Botanik dhe fletë për shijet e këtyre njerëzve ndaj së bukurës!

Pa, do të jenë edhe ata që vijnë këtu të pushojnë, poshtë në Bunec, ku Eni Shehu do të takohej me një mysafire të rrallë, rusen Ana nga Ekaterinburgu i largët, që ecte zbathur mbi barin e



Mitro Xhani, Hero i Popullit

buzëlumit, pak më larg nga kulloste tufa e deleve... "Më pëlqen jeta e fshatit, -tha ajo, - Dhe në një plazh si BUNECI, ku të kënaqet shpirti! Ajo e fliste shqipen me ndërprerje, po saktë e bukur. Ajo, "Birzozka Ruse" e mësuar në dëborën e atyre anëve... Pak më tej, një pushues stërvitej në ecjen mbi tel, një pelivan mbi litarin e tendosur midis dy ullinjëve të vjetër". Pa spektatorë! Një tjetër turist shqiptar, nga Kosova a Maqedonia, këputi në pemën e limonit dy kokrra të mëdha e të verdha e i'a zgjati gazetarit të mahnitur prej gjithçkaje që shihte. E flisnin e flisnin, derisa ra mbrëmja e "Saçi i Diellit" përsquqi horizontin, duke afruar me limanin e Bunecit, ku dikur shtriheshin edhe sulinat e ujit të pijshëm, ku ankoronin e furnizoheshin marinarët tane e ata të huaj... E ku ta dinte kjo "Birzozka Ruse" se, afro 200 vite më parë, po këtu ka shkelur këmba e Admiralit Rus Ushakov që të furnizonte me ujë anijen

fshihen plazhet e virgjëra, trampolinat e shkëmbinjëve, burimet natyrore të ujit, tendat me sqinde, gjiret ku pushojnë pulëbardhat, pa u trembur nga çiftet që preferojnë intimitetin e vetmisë, si edhe ku instalohen tek-tuk, me shpejtësi, çadrat e mënjauara të turistëve italianë e nordikë! Një Atraksion i veçantë, që afron me magjinë reale...Ja ku i ke edhe lulet që u mbollën nëpër gommat e nxjerra nga deti e u lyen me bojë të bardhë, - vazhdon të thotë ai që zgjodhi Bunecin, - Të shoh vetë Perëndia këtu, o NJERI, -larg zhurmave e streseve... E nuk ke gjë tjetër të thuash veçse: "EJANI NË PIQERAS!"

Gjithçka e thënë dhe e shprehur bukur me fjalë, figurë vizive e muzikë qetësuese,



Vasil Llaçi, Hero i Popullit

nga ku burojnë disa mesazhe që nuk janë thënë më parë për fshatin e dy heronjve të famshëm, Mitro Xhanin e Vasil Llaçin. Po edhe me nostalgjinë e brengën nga "Ulliri i Lotëve!", midis Bunecit e fshatit, nga ku-shprehet me dhimbje Miho Nini, -përcilleshin kurbetlinjtë e parë, që iknin e vinin me detarët trima piqerasiotë, të atyre që rrihnin detrat e botës e prapë ktheheshin. Mësuesi veteran Gjivogli dhe ish Kryeplaku më i moshuar Arsen Konomi rrëfejnë mandej, për ato 19 familje piqerasiote që krijuan Villa Badesën në Itali, midis Romës e Pescarës dhe për ato 23 familje të tjera, që nuk u strehuan dot në Itali e morën rrugën e Moresë, duke themeluar fshatin e Neo Piqernit në Peloponez të Greqisë (dhe ku do t'i zhdukte që të gjithë Pandemia e Kolerës"!). Po edhe për ata që mbetën gjallë këtu ndërt breza të mëvonshëm e dy shekuj më mbrapa, u "ropën deri në palcë" nga punët vullnetare ndër ato 50 vite që i la të varfër sa s'ka, pa pronë e katandi elementare, ca më keq se pandemia e sotme. "Përse vallë, të vejë Piqerasioti, -thuhet në këta filma e të shesë krahët në afërsi të Polit të Veriut e të atij të Jugut e të braktisin fshatin e tyre të mrekullueshëm? Parajsa e tyre këtu është e këtu do të jetë!" "Piqerasi, -tha njeri prej këtyre turistëve të huaj, -nuk është vetëm një pasuri e juaja, kombëtare, po edhe botërore! Këtu njeriu është Zot i Vetes dhe i Natyrës së Virgjër...!"

e tij luftarake! Po kohët ecin, ndryshojnë dhe njerëzit kur vijnë këtu dhe as që duan t'ia dinë se ç'është bërë, po për atë se, çdo të bëhet më tej.

Po, ja ku është edhe një peshkatar i vonë që ka hedhur fillon e pret t'i avitet ndonjë peshk i egër për mezen e mbrëmjes. Peshkatarit thotë se kjo është "një biçim Lungo Mare" e Bunecit dhe, kushdo që vjen këtu, do të vijë përsëri, si të ishte një eksplorator i natyrës pambarim, ku

Flet Gentjan Qejvanaj: Nismën për të udhëtuar me biçikletë nga Pekin

FJALË E DHËNË, PËR GENTIAN QEJVANAJ PËRFUNDOI AVENTURËN

Nga: Besnik Gjonbrataj

Kush është Gentjan Qejvanaj ?

Gentian Qejvani ka lindur në Vlorë në 31 gusht 1987 nga prindërit e tij Memo Qejvanaj dhe Zamira Isufi. Memua, babai i Gentianit rrjedh nga një familje e thjeshtë dhe bujare kallaratase, i cili në një moshë të re u nda nga jeta duke punuar në sektorin e naftës dhe la pas dy fëmijë në moshë të mitur, Fatjon dhe Gentian Qejvanaj. Në kohën e ndryshimit të sistemit mamaja e Gentianit i mori dy fëmijët e mitur dhe emigroi në Itali. Me sakrificë dhe përkushtim ajo i rriti, edukoi dhe shkolloi dy djemtë e saj që u diplomuan në shkollat e larta Italiane. Gentiani u diplomua në Itali për Shkenca Politike, ka kryer Masterin në Bruksel. Gjithashtu ka punuar një vit në Parlamentin Europian. Mbas mbaroi masterin ai shkoi në Kinë ku vazhdoi të studioje dhe të diplomohet me PhD (Doktoraturë) në çështjet publike me një studim krahasues midis Shqipërisë dhe Kinës. Gentit nuk i mjaftoi karriera akademike, por vazhdoi të merret me aktivitete sociale dhe sportive që zhvillohen në Kinë, ku doli fitimtar dhe mori çmimin e parë në disa maratona kineze, si edhe lartësoi flamurin shqiptar në çiklizëm. Ai vazhdon të promovojë Shqipërinë dhe kulturën shqiptare në Kinë, duke u përpjekur të jetë një urë lidhëse midis dy vendeve.

Fjalë e dhënë para një viti, më 12 gusht 2023

Gentian Qejvanaj duke marrë pjesë në "Takimin e Brezave" në Kallarat deklaroi se në takimin e vitit tjetër 2024 "do të realizojë aventurën më të gjatë të jetës time, atë ardhjes me biçikletë nga Kina në Kallarat". Gentian Qejvani, i ndodhur prej disa ditësh në Kallarat (pasi prej 10 vitesh jeton në Kinë), ardhur me mjetin e tij të preferuar, biçikletën, mori pjesë për herë të parë në takimin e brezave në vendlindjen e babait të tij Memo Qejvanaj. I them prezantueses se Genti është një djalë me origjinë nga Kallarati, sportist në Kinë dhe do të jap një mesazh pjesëmarrësve. Dakord - tha Anila - mikrofonin është për të. Genti mori në dorë mikrofonin dhe në fjalën e tij, pasi u prezantua me një shqipe të kuptueshme, falenderoi organizatorët për këtë event shumë të bukur, përhëndeti të gjithë kallaratasit dhe në fund dha fjalën se, në takimin e vitit tjetër do vij në Kallarat me biçikletë nga Kina. Duartrokitje të mëdha nga pjesëmarrësit ushtuan sheshin. Para disa vitesh Gentiani së bashku me 5 kinezë ishte në Berat, Vlorë e Sarandë, pa anashkaluar edhe Kallaratin vendlindjen e babait të tij, Memo Qejvanaj, njeriut të urtë e punëtor, për të promovuar turizmin dhe bukuritë natyrore të Shqipërisë.

Fjalë e mbajtur pas një viti, 5 gusht 2024. Pritja në Kallarat, organizuar nga Shoqata "Kallarati". Ashtu siç e kishte parashikuar vetë "aventurieri" Gentian Qejvanaj, më 5 gusht 2024, ora 16:00 mbërriti në Kallarat,



pasi një ditë më parë ai kishte kaluar pikën e kufirit në Qafë Botë, ku u prit nga vëllai i tij Fatjoni. Gentiani u ndie i lehtësuar e plot emocione që më në fund pas gjithë atij

për mbajtjen e fjalës së dhënë një vit më parë për përshkrimin e rrugës së gjatë Kinë - Kallarat me biçikletë, si dhe për mesazhet e përcjella prej tij në mediat e ndryshme ku



udhëtimi të gjatë midis dy kontinenteve dhe shumë shteteve, shkeli me biçikletë tokën shqiptare. Më tej ai vijoi udhëtimin drejt Kallaratit, ku në hyrje të Kallaratit, në kufirin me Kuçin kishin dalë familjarët, të afërm dhe bashkëfshatarë të tij. Udhëtimi vijoi drejt qendrës së fshatit, në Morrez, aty në sheshin kryesor të Kallaratit aty ku një vit më parë dha fjalën për këtë udhëtim aventuresk, të cilën më në fund e bëri realitet. Qendra e fshatit ishte zbuluar me flamuj, parrulla, ku binte në sy një banderolë e madhe me foton e tij dhe biçikletën. Për të pritë birin e tyre, edhe pse kohë e nxehtë e temperatura të larta kishin dalë shumë bashkëfshatarë, banorë të Kallaratit, por edhe të ardhur nga fshatrat fqinjë dhe qyteti i Vlorës. Duartrokitje, brohoritje për Gentianin, takime të përzemërta, përqafime, lot e gëzim nga familjarët e tij. Kryetari i shoqatës Kallarati z. Kastriot Karaboli, kryeredaktori i gazetës 'Kallarati' z. Lefter Hysaj, etj i uruan Gentianit mirëseardhjen në Kallarat dhe e përgëzuan

kryefjala ishte fjala 'Kallarat'. Në fjalën e tij Gentiani falenderoi pjesëmarrësit, familjen, të afërmit, bashkëfshatarët, si dhe kryesinë e Shoqatës "Kallarati", për mbështetjen morale dhënë gjatë gjithë udhëtimit, si dhe pritjen mjaft të ngrohtë e mbresëlënëse organizuar në qendër të fshatit.

Pritja në Vlorë, organizuar nga Bashkia

Në mbrëmjen e datës 5 gusht 2024, ora 19:00 çiklisti Gentian Qejvanaj mbërriti në Vlorë në qytetin e tij të lindjes. Aventura e Gentianit, e nisur më 30 qershor nga Kina me biçikletë përfundoi në Vlorë.

Në Vlorë, para Pallatit të Sportit Flamurtari, bashkia e Vlorës, sektori i sportit kishte përgatitur një pritje simbolike dhe shumë domethënëse. Në hyrje të Vlorës Gentiani u prit nga një grup çiklistësh të Vlorës, të cilët e shoqëruan atë drejt Pallatit të Sportit. Mbërritja e tij me biçikletë u prit me



duartrokitje të forta nga pjesëmarrësit. Merrnin pjesë mjaft qytetarë të zakonshëm vlonjatë, njerëz të sportit, bashkëfshatarë kallaratase me banim në Vlorë, por edhe të ardhur enkas nga Kallarati, si dhe familjarë e të afërm të Gentianit. Merrnin pjesë gjithashtu nënkryetari i bashkisë së Vlorës z. Klevis Taso, drejtoresha e sportit po të bashkisë znj. Elona Merkaj, si dhe kryetari i shoqatës "Kallarati" z. Kastriot Karaboli.

Intervista:

Kalova nëpër Kinë-Kyrgyzistan-Taxhikistan-Uzbekistan-Azer-baixhan-Gjeorgji-Tuerky-Greqi.

- Kur e filluat nisjen nga Kina dhe nga cili qytet?

Më 30 qershor bëra nisjen nga Kina.

- Cili është itinerari i udhëtimit duke



Mi në Kallarat e mora për të treguar vitalitetin e shqiptarit

PREMTIM I MBAJTUR

FJALËN ME BIÇIKLETË KINË - KALLARAT - VLORË



përmendur shtetet me radhë?

-Kinë-Kyrgyzistan-Taxhikistan--Uzbekistan-Azerbaixhan-Gjeorgji-Tuerky-Greqi.

- **Kilometrat gjithësej të përshkruara me biçikletë?**

-3600 km.

- **Sa kilometra afërsisht në ditë realizoje?**

-150 km.

- **Ku pushoje ose flije?**

-18 ditë në çadër që e mbaja në biçikletë dhe 17 ditë në hotele.

- **Probleme të ndodhura gjatë rrugës (shfryerje gomash, etj)**

-Gomat mu shpuan 9 herë që m'u desh t'i riparova në servise gjatë rrugës.

- **Cilën rrugë do të konsideroni më të vështirë të përshkruar dhe sa metra mbi nivelin e detit?**

-Rruga më e vështirë ishte kalimi në malet e Kyrgyzistanit rreth 3500 m mbi nivelin e detit.

- **Dy fjalë për kalimin në "Tunelin e Vdekjes"?**

-Tuneli i vdekjes është 5km pa drita e ventilator ku të mungon ajri, shumë çiklista kanë vdekur nga pamundësia e ajrosjes.

- **Cilat ishin temperaturat gjatë udhëtimit dhe si i përballojë?**

Temperaturat ishin të larta sidomos në Uzbekistan mbi 38 gradë celsius.

- **Si arrije të filmoje veten e të bëje video?**

-Me anë të një droni të vogël, filmoja vazhdimisht udhëtimin tim. Do punoj që në shtator të bëjë një video përmbledhëse të gjithë udhëtimit dhe t'a hedh në Youtube në kanalim tim, që e kam prej 5 vjetësh "G productions", ku kam shumë video nga aventurat e mia.

- **Si ndikonin intervistat e marra nga mediat shqiptare gjatë udhëtimit?**

-Kam pasur një interesim të madh të mediave shqiptare në Skype, ku në pushimet që kam bërë kam pasur mundësinë të bëjë të ditur për publikun shqiptar aventurën time, ku gjej rastin t'i falënderoj si: TV Klan, Top Chanel, TV Raport, Skan ZV, TV 6+1 Vlora. Këto intervista më kanë ngritur

moralin më lart. Po kështu shoqata e fshatit të vendlindjes së babait tim "Kallarati" në fejsbukun e vet ka pasqyruar vazhdimisht udhëtimin tim.

- **Udhëtimi juaj me biçikletë, a ndiqej nga federata e çiklizmit në Kinë?**

-Jo federata kineze nuk ka pjesë në aventurën time, por grupe lokale me kanë mbështetur.

- **Në të gjithë këtë aventurë, a kishe sponsorizues?**

-Sponsorit kinezë më kanë ndimuar me

shumë domethënës, sepse po hyka në atdheun tim për të cilin mora këtë aventurë, por pas kalimit të kaq shumë kufijve ishte vetëm një më shumë, por ky ishte i fundit.

- **Po kur takove nënën tënde?**

- Vëllai i madh Fatjoni, i cili jeton në Suedi kishte dalë në kufi, kurse mamaja Zamira më priste në Kallarat. U gëzova shumë kur pashë mamën, sepse ajo si gjithë nënat ishte në merak të madh dhe kishte një muaj që më ndiqte, aq më tepër që babai më është

e marrjes me sport?

Ushtroji çdo lloj sporti se është jetë, aq më tepër ecjet e gjata dhe çiklizmin.

- **Çfarë është "Tuneli i vdekjes"**

-Tuneli Anzob supozohej se do ua bënte jetën më të lehtë njerëzve që do të donin të udhëtonin në mes të qyteteve të mëdha të Taxhikistanit. Para se të ndërtohej tuneli, shoferët duhej të kalonin kufirin në Uzbekistan nëpërmjet një rrugë të paasfaltuar në mënyrë që të udhëtojnë në mes kryeqytetit Dushanbe, dhe qytetit të saj të dytë më të madh, Khujand. Ata gjithashtu u përballen me kërcënimin e orteqeve, gjatë gjithë vitit, pas bllokimit të rrugëve, duke i lënë njerëzit me opsionin e vetëm – fluturimin me aeroplan – udhëtim shumë i shtrenjtë për shumicën. Kështu që tuneli i gjatë rreth 5 kilometra, që kushtoi rreth 4 miliardë dollarë, i ndërtoar nga Irani, mendohej të ishte një hap përpara. Tuneli u hap zyrtarisht në vitin 2006, por mbeti i papërfunduar deri në mars të vitit të kaluar. Pas një problemi, ai u desh të mbyllej për riparim dhe të rihapej në shtatorin e vitit të kaluar. Ai shpejt u bë i njohur si "tuneli i vdekjes" nga vendasit dhe ata që u sfiduan nga ankthi i udhëtimit. Është një vend i errët e i rrezikshëm, me drita të rralla brenda dhe mbytës pasi nuk ka ventilim. Vendorët kanë ndarë historitë e një numri të njerëzve që kishin mbetur të vdekur brenda për shkak të bllokimit të trafikut, ku ata i ishin nënshtruar monoksidit të karbonit. Fakt tjetër është edhe prezenca e gropave të mëdha, të cilat në rast të reshjeve, pothuajse kthehen në pellgje. Rreziku nga shkëmbinjte e rënë është gjithashtu prezent dhe ju duhet të jeni shumë vigjilent në qoftë se merrni një udhëtim nëpërmjet tij. Është gjithashtu mjaft i ngushtë - me një sistem me dy korsi, me "kufijtë" shpesh të injoruar nga shoferët. "Edhe në kushte të mira atmosferike tuneli është i përmbatur. Kanale të pashënuara kulluese. Tunelit i mungon ndriçimi i duhur dhe ventilimi, frymëmarrja është e vështirë".

- **Kallaratasit si pjesë e Labërisë kanë në gjak patriotizmin dhe mbajtjen e fjalës së dhënë**

- **Momenti më i bukur ishte ku pas një viti dhe 3600 km rrugë përqafova nënën në Kallarat**

- **Më 5 gusht 2024, ora 16:00 mbërrita në Kallarat, pasi një ditë më parë kisha kaluar pikën e kufirit në Qafë Botë**

- **Aventura e Gentianit, e nisur më 30 qershor nga Kina me biçikletë përfundoi në Vlorë më 6 gusht.**

pjesë këmbimi për biçikletë, por edhe ekonomikisht që në muajin mars kur vendosa të ndërmarrë këtë aventurë.

- **Cilën pjesë të udhëtimit e konsideroni më të vështirë dhe pse?**

-Kalimin në malet e Pamirit në Tagikistan-Kyrgyzistan- Kinë ishte pjesa më kritike për erën e fortë dhe notin e keq me shi.

- **Cilën pjesë të udhëtimit e konsideroni më të bukur dhe pse?**

- Kalimi në Gerogja ishte mjaft e bukur dhe sidomos në Shqipëri gjatë kalimit në bregdetin e Sarandës.

- **A të shkoi ndonjëherë në mendje t'a ndërprerje aventurën?**

- Jo, asnjëherë nuk kam menduar kurrë të dorëzohem edhe pse kam marrë shpime në të dy rrotat disa herë. Fjalën e dhënë para Kallaratis, dëshiroja t'a bëja realitet.

- **Si u ndjeve kur hyrë në kufirin shqiptar?**

- Kalimi i kufirit shqiptar në Qafë Botë, ishte

ndarë nga jeta vite më parë. Kështu që isha i lumtur që e pashë dhe nuk e ndanim njëri tjetrin nga përqaftimi me mall.

- **Si e konsideroni pritjen në qendër të fshatit të Kallaratis dhe banderolën me foton tuaj?**

- Mirëpritja si në Kallarat ashtu edhe në Vlorë ishte e mahnitshme. U befasova vërtet kur pashë se kaq shumë njerëz ishin të lidhur dhe të interesuar për aventurën time në përputhje me rrethanat. Gjej rastin të falënderoj shoqatën Kallarati dhe bashkinë e Vlorës.

- **Aventurat tuaja të ardhshme, apo me kaq deri këtu?**

-Ndjej sikur kjo aventurë nuk po kalon këtu, mund të ketë diçka që do të ndodhë vitin e ardhshëm ose ndoshta edhe më herët. Do t'ju mbaj të informuar dhe shpresoj shumë që mund ta bëj këtë aventurë herën tjetër me ndonjë shqiptar tjetër që mund të frymëzohet nga përvoja ime.

- **Mesazhi juaj për të rinjtë në aspektin**

Poeti i Vjosës Petrit Ruka përkujtohet në 70 vjetorin e lindjes me “vdekjen në xhep”

Ese me rastin e 70 vjetorit të lindjes



Nga: Namik Jahaj

**Nuk kam ku të shkoj me këto shtatë mijë shira
Dhe cadër nuk kam, ma vodhën që në djep.
Unë vuajtje për vuajtje kam zgjedhur mërzinë
Dhe tërr s'ma bën syri me vdekjen në xhep.**

Petrit Ruka

Më datën 20 gusht poeti i papërsëritshëm Petrit Ruka mbush 70 vjec. Po e them vullthi se poeti i dashur i lexuesit shqiptar iku shpejt nga kjo botë. Petrit Ruka është autor i disa vëllimëve poetike, por gjithashtu ai është skenarist filmash, regjizor, intervistues, publicist, eseist, biograf e autor tekstesh. Në këtë 70 vjetor e kujtoj kur para shumë motesh më erdhi në shtëpinë. që porsa e kisha ndërtuar rrëzë një shkëmbi në shpatin e përroit të Shashicës në Vlorë. Nuk ishte vetëm. E shoqëronte aktori Kadri Rosh. Ime shoqe Ana nën hijen e manit nxori nga një gotë

raki me mezet që ju ndodhën. Folëm gjatë. Kadri Rosh ja mori këngës: - /Kush je ti o lule - djali//Që na vjen nga Shqipëria?//Unë jam Smail Qemali//Prapa më vjen historia/. Jeta bëri të sajën. Kadr Rosh vdiq. Pas vdekjes së aktorit të madh poeti dhe miku i Kadri Roshit shkroi një monografi për gjeniu shqiptar të skenës. Ja cfarë shkruan poeti Petrit Ruka në mbyllje të librit: -“Kadri Rosh, kalorësi mbi det” në vitin 2008: “Mos vallë Mjeshtri i madh, aty në arkën prej druri, po luan të vdekurin”. Në këtë 70 vjetor në esenë kushtuar poetit të papërsëritshëm Petrit Ruka nuk mund të përmblihen në gjithanshmëri e tërë krijmtaria e tij me atë muzën që e trashëgoi nga Turhani, ku lindi në malet e Tepelenës.

Bashkëshortja e Petrit Rukës tregon se bashkëshorti Petriti në një kënd të bibliotekës e kishte shkruar një thënie të Gëtes: - “O mik! Jeto edhe vazhdo thur vargje”. Dhe poeti i rrallë shkroi papushim poezi edhe në trajtat apokaliptike. Ruka në bisedat që bënim në Vlorë dhe në Tiranë e citonte me zë të lart idhullin e tij Gëten që ka shkruar se “kohë të marra rrojta”. Dhe poeti Petrit Ruka në



Petrit Ruka

thagmën e gurrës së poetit si mendëtar grahu në dritë hije me mbrothësi poezitë autentike me ndjesi artistike plot një tufan me krijme sic qenë librat: - “Rinia ime”. “Atdheu fillon te zemra”, “Mirupafshim,

Në këtë 70 vjetor në esenë kushtuar poetit të papërsëritshëm Petrit Ruka nuk mund të përmblihen në gjithanshmëri e tërë krijmtaria e tij me atë muzën që e trashëgoi nga Turhani, ku lindi në malet e Tepelenës.

hënë e vendlindjes”, “Vërtitu, kokë e prerë”, “Në zemër bie shi”, “Poezi të zgjedhura” si dhe mbi 30 vepra vepra kinematografike. Poeti Petrit Ruka me pikë e me presje ka një bollëk trajtash në veprën e tij, ku

ai i ka yjzuar poezi të ndjera jetës sonë shpesh dramtaike. Bruti thotë tek Jul Cezai se “ditë e ngrohtë na e rrit nepërkën”. Poeti i kristaltë me fosilen e gjallë të gjuhës së sotme shqipe me paansësi deri në asht nëpërmjet muzës qibare solli në letërsinë shqipe orakujt e ngjyrëzuar të botës shqiptare si në socializëm dhe në demokraci. Megjithë larushit flatërore poezitë e Rukës mbeten dykuptshmërisht vagëllimthi kronika e Tepelenës ku lindi. Ja cfarë shkruan poeti Petrit Ruka në poezinë: “E shkreta nëna ime”: - /E shkreta nëna ime//Tri ditë e tri netë në koma//Vdiq në një nga datëlindjet e mia/. Miku im Petrit Ruka iku para kohe. U nda nga kjo jetë me shumë lëngata. Në rradhë të parë kishte detyrime për bashkëshorten të cilën lexuesi e gjen pas cdo vargu, poezie e skenar filmi. Kur ai kthehej nga

udhëtimetelargëtairegontebashkëshortes për përshtypjet, për motivet, për lëndinat e Turhanit e për këngën e bilbilave. Jeta e poetit Petrit Ruka nuk qe kurrë e qetë. Mbeti me gisht në gojë në socializëm dhe zhgënjimet s’ju ndanë as në demokraci. Poezitë që shkruante nuk e kishin forcën e “bombave”. Maskarenjtë e Ali Asllanit dolën më të fortë. Nuk mundeshin. Përlanë pasurinë e popullit, lumenjtë, pyjet, brigjet e detit, ndërtuan qytete në tokën e bukës, nxitën vëllavrasjen e u vunë në shërbim të agjenturave të huaja. Të gjithë këtë dramë lexuesi e gjen në veprën e tij të plotë. Në poezinë: “Atdheu fillon te zemrat” shkruan midis të tjerave se: - /Atdheu është te këngët tona//Hap ato të gjesh mallet, fushat//Të gjesh cdo pëllëmbë të dheut e të qiellit/.

Homazh për heroin e popullit Misto Mame, rënë në 16 gusht të vitit 1942

M’u rrite nën dhe o bir!

Këto ishin fjalët që dolën nga shpirti i plagosur i Aspasi Mames, nënës së heroit të popullit Misto Mame, ditën kur eshtrat e heroit u nxorrën nga varrezat e vjetra për t’u prehur përfundimisht në varezat e dëshmorëve të kombit

Me siguri një det dhimbje dhe malli kishte në ato çaste në zemër ajo nënë shamizezë, tek shihte eshtrat e të birit të vvarë vetem 21 vjeç. Dhe ishte djali i vetëm midis katër motrave. Por ja që edhe bijtë e vetëm vriten për vatanin. M’u rrite nën dhe o bir,- mërmëriste nëna. Ajo e dinte shumë mirë që njeriu nuk rritet nën dhe, por ato fjalë drithëruese të dala nga dhimbja dhe të mbështjella me lot, donin të thonin se biri i saj i vetëm ishte vvarë i ri, shumë i ri. Ende i parritur. 21 vjeç.

Në lulen e moshës, në lulen e rinisë. Ndoshta duke pëshpëritur ato fjalë lapidare, mendimi i nënë Aspasisë endej nëpër rrugët dhe rrugicat e Tiranës ku ajo ndoshta shkonte për herë të parë



Misto Mame

« Kush iu ndodh pranë dkur u vra, si u vra, ku u vra, kush ja mbylli sytë e bukur, dhe ç’amanete kishe marrë me vete i biri që nuk mundi t’ja thoshte dot nënes »?!

Sepse nëna banonte larg, në Erind të Lunxhërisë, ndërsa i biri ilegal në rrugët e Tiranës. Ishte kohë lufte kur Shqipëria ishte pushtuar nga fashizmi.

Pas luftës nëna kishte udhëtuar nga Erindi në Tiranë për » të takuar djalin, të çmallej » e t’i thoshte ca fjalë atje në buzë të varrit, ca fjalë që dinë t’i thonë vetëm shamizezat shqiptare.

M’u rrite nën dhe o bir! Vetëm laboratorit i shpirtit të nënave si Aspasia, vetëm kimia e gjakut të tyre mund te të krijojë këto fjalë që të tronditin gjer në eshtra. Heroi i popullit Misto Mame lindi në Erind të Lunxhërisë në 21 korrik të vitit 1942.

Për shkak të aktivitetit të tij antifashist, kuestura italiane kishte lëshuar urdhër të prerë: Djaloshi i ri i shkurtër dhe me flokë kaçurela të vritet kudo që të gjendet dhe pa paralajmrim »

I ndodhur befasisht përballë një patrulle fashiste në mëngjesin e 16 gushtit @ 1942, ai luftoi si luan deri në fishekun e fundit, deri në frymën e fundit.

Dhe ra si një lastar i prerë...

Ishte koha e idealistve dhe Misto Mame ishte idealist.

Lavdi tërënëve për Atdhe!



MEMO NEXHIP BEJKO HEROI I PAVDEKËSISË LABE ME BUST TË RI NË DUKAJ

(Biri i fshatit Dukaj vjen në fshatin e lindjes në bust këtë 3 gusht 2024 në kuadrin e 98 vjetorit të lindjes dhe 75 vjetorit të rënies të heroit dhe dëshmorit Memo Nexhipi (1.4.1926-2.8.1949); mirënjohje birit çmuar të fshatit Dukaj, Tepelenës, Labërisë dhe mbarë shqiptarisë. Memo Nexhip Bejko është shpallur "Hero i Popullit" nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, dhe titullin "Dëshmor i Atdheut" me Vendim nr. 157 datë 10.12.1983 të KE të KP të rrethit të Tepelenës. Ai shkroi pavdekësi në memorien e kombit shqiptar dhe është i vetmi hero ndër 87 dëshmorë në luftën për mbrojtjen e truallit atdhetar më 1949. Vlerësimi me titullin e lartë Nder i Qarkut Gjyrokastër ishte i pritshëm, pas kërkesës së bërë nga Kryesia e SHAK "Labëria" dega e Tiranës).



Nga: Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Data 3 gusht e këtij viti ishte ditë feste e dyfishtë në Dulaj të Labërisë. Djali i këtij fshati kishte pritur gjatë plot 75 vite që të rikthehej në memorial pavdekësie, pasi ai ra në Vidohovë në luftë për mbrojtjen e truallit shqiptar në përballje me monarko-fashistët grekë që sulmuan territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo përkonte edhe me 80 vjetorin e çlirimit. Më shumë se 600 vetë erdhën për të pritur kapiten Memo Nexhipin në Dukaj, sikurse ishin pjesë e këtij festimi edhe Kryetari i Qarkut, Kryetari i Bashkisë dhe shumë personalitete të Labërisë e më gjerë. Falënderimi i parë është për atdhetarin e shquar Luan Muça, Hamit Kaba, Myrdar Jera, Arben Prasta, Gazi, Fatmiri dhe mjaftë bijt e bija të fshatit Dukaj. Grupi polifonik i Dukaj i dha gjallëri të madhe aktivitetit, ndërsa mbritja e bilbilave të Fushëbardhës të Sefer Muhos dhe grupit ja shtoi dimensionin aktivitetit në mbrëmje, pasi kur "flasin" bilbilat e labërishtes heshtin bilbilat në degët e pemëve, pasi dëgjojnë këngët e shenjtëruara labe.

Kur gjykojmë për të shkuarën 75 vite më parë, rrethanat flasin se ishte luftë e shqiptarëve për mbrojtjen e truallit arbëror dhe jo "provokacion ushtarak monarkofashist grek", që filloi në "befasi", në një kohë kur zbulimi ushtarak kishte kufizime dhe limite. Lakmia e megaliidhesë nuk kishte dhe nuk ka të sosur. Shqiptarët janë sulmuar pesë herë nga Greqia në një shekull. Më 2 gushtit 1949, në juglindje me bazë rajonin e Korçës, e deri në Konispol të Sarandës në Likojan, ja kthyen reston fuqishëm, por edhe me gjak. Sipas dokumenteve arkivore, në sulmin e 2 gushtit, grekët përdorën kundër Shqipërisë ushtrinë me topa, avionë, ushtri tokësore e gjithçka që përdor çfardo ushtri që synon pushtimin. Ushtria shqiptare, iu kundërpërgjigj sulmit pushtues grek, me luftë në mbrojtje të kufijve e trojeve të të parëve. Greqia e sulmoi Shqipërinë me mbi 70000 ushtarë, 50 avionë, 80 tanke, 400 gryka zjarri, kryesisht topa. Ushtria Kombëtare Shqiptare që ishte një ushtri 5 vjeçare futi në luftimet aktive mbrojtëse 10.000 ushtarë, ndërkohë kryen rigrupim e përqëndrim pranë rajonit të veprimeve luftarake rreth 30 mijë trupa të tjerë, në gatishmëri për të vepruar në fushën e betejës.

Greqia ka pasur pretendime e synime

historike për rrëmbim të trojeve shqiptare, kishte bërë 700 provokime tokësore, detare e ajrore dhe acarime greke, që në fakt pala shqiptare i priti me vendosmëri, dhe në orën 4.30, të 2 gushtit 1949, nisën sulmin ushtarak, në zonën e Bozhigradit, Mirasit me artileri e forcave ushtarake, duke goditur me mortaja dhe artileri kodrën "1309" mbi fshatin Vidohovë, nga predhat e të cilave vranë oficerë, ushtarë dhe civilë shqiptarë. Sulmi nisi me predhat e artilerisë që ranë deri 350-400 m në thellësi të tokës shqiptare. Në Vidohovë mbrohej një togë kufitare me një efektiv 36 vetë. Mirëpo nuk kaluan veçse disa orë dhe Forcat Kufitare dhe të Divizionit të Mbrojtjes së Popullit filluan kundërsulmin dhe i detyruan trupat ushtarake greke të tërhiqen me dështim të plotë, që në orët e para të sulmit. Memo Nexhipi, biri i Labërisë flamur frymëzimi në breza, që sot kemi në bust nga bijtë e këtij fshati në Dukaj ishte krenaria dhe flamuri i frymëzimit në breza, ishte lavdia, krenaria dhe mirënjohja e shqiptarëve, për një bir

gjeti Memon në Vlorën e flamurit. Fillimi i LANÇ-it ishte për Memon sinjali i një lëvizjeje të madhe antifashiste ku shquhet si partizan në çetat e para të zonës Tepelenës. Në shtator 1943 kishte marrë pjesë në forcat partizane të batalionit "Baba Abaz",

Data 3 gusht e këtij viti ishte ditë feste e dyfishtë në Dulaj të Labërisë. Djali i këtij fshati kishte pritur gjatë plot 75 vite që të rikthehej në memorial pavdekësie, pasi ai ra në Vidohovë në luftë për mbrojtjen e truallit shqiptar në përballje me monarko-fashistët grekë që sulmuan territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo përkonte edhe me 80 vjetorin e çlirimit. Më shumë se 600 vetë erdhën për të pritur kapiten Memo Nexhipin në Dukaj, sikurse ishin pjesë e këtij festimi edhe Kryetari i Qarkut, Kryetari i Bashkisë dhe shumë personalitete të Labërisë e më gjerë



që shpirtin e kishte trupëzuar përjetësisht me kombin, prandaj dhe atje në Vidohovë shkroi pavdekësinë.

Memo Nexhip Bejko ishte lindur në Dukaj të Tepelenës më 1 prill 1926. Babai i tij, Nexhipi, kishte marrë pjesë në luftën kundër andartëve grekë në vitin 1914 dhe në Luftën e Vlorës më 1920, bashkë me Selam Musa Salarinë, që shkruan një histori trimërie dhe guximi për mbarë shqiptarinë dhe i bashkuan trevat jugore me trungun mëmë. Babai dhe nëna e Memos, Nexhipi dhe Vezikua shquheshin në fshatin Dukaj dhe në gjithë krahinën si familje atdhetare, patriotike e njerëzore, e nderuar dhe respektuar. Me këto tradita atdhetare u edukua që në fëmijëri edhe Memua, i cili dallohej midis shokëve për zellin për të mësuar si dhe për zhdërvjelltësinë në veprime praktike. Nën frymën e atdhetarisë labe u edukua dhe dallohej midis shokëve edhe për njerëzillëkun dhe dashamirësinë. Kushtet e vështira ekonomike e detyruan Memon që të bënte vetëm tri klasë shkolle fillore, ndërsa në moshën 14 vjeçare shkoi në qytetin e Vlorës, ku u punësua në fabrikën e vajit dhe alkoolit. Pushtimi italian i 7 prillit 1939 e

në batalionin territorial të Kurveleshit dhe çetat e fshatrave që rrethuan qytetin e Tepelenës dhe më 15 shtator 1943 e çliruan atë. Më tej Ai inkuadroheshin në radhët e Brigadës II Sulmuese, si pjesë e luftëtarëve të ZIO që do të shkonin në Shëngjergj të Tiranës. Kështu në nëntor 1943, bashkë me shokë të tjerë, ai u rreshtua si partizan në këtë brigadë. Në ditët e Operacionit armik



të Dimrit 1943 – 1944, Memua veproi në rrethinat e Tepelenës dhe Kurveleshit. Viti 1944 ishte viti vendimtar i luftës dhe si pjesë e BrIIS e UNÇSH-së të krijuar më

28.11.1943 në Shëngjergj të Tiranës Memo Nexhipi u shqua për trimëri e mençuri në këtë formacion të madh luftarak që i dha atdheut 85 dëshmorë. Pas çlirimit u emërua në radhët e Ushtrisë Popullore, si kuadër isaj. Batalioni ku bënte pjesë Memua menjëherë pas fitores mbi fashizmin, që dislokuar në fshatin Hoçisht të Devollit, që ishte një zonë kufitare. Memoja me thjeshtësinë e tij kishte fituar respektin e ushtarëve të batalionit, të cilit ia dëgjonin me vëmendje fjalën dhe ja zbatonin urdhërin luftarak. Në ato anë ku vepronte batalioni lëviznin herëpashere banda diversioniste. Njëra prej bandave diversioniste vrau në befasi komandantin e batalionit, Neshat Duro Kondi (1913-1945) nga Fushëbardha, më 1945 në Bilisht, akt që e dëshpëroi Memo Nexhipin, por në të njëjtën kohë atij i shtoi forcat dhe urrejtjen për armiqtë e pabesë. Nga veprimet diversioniste, provokacionet greke në kufijtë e jugut arritën në shkallën e një agresioni luftarak të mirëpërgatitur, edhe pse nuk e kishin parashikuar se, kundërveprimi energjik shqiptar do të ishte edhe më i ashpër, edhe më i vendosur.

Më 2 Gusht 1949 falangat greke kaluan në mësymje në sektorin e Vidohovës. Provokacionet u shtrirë edhe në Trestenik, Kapshticë, Vernik, deri në sektorin e Leskovikut. Forca e parë luftarake që u shkoi në ndihmë kufitarëve trima të Vidohovës ishte kompania që komandohej nga kapiteni Memo Nexhipi dhe nëntogeri Ferit Bregasi. Komandant Memos në këto luftime iu dha e drejta të komandonte gjithë batalionin, që mbështeste drejtimin e postës heroike të Vidohovës. Pozicionet e luftimit u zunë së bashku me kufitarët. Armiku ishte gozhdur në vend brenda tokës sonë dhe po organizonte groposjen në llogore fushore. Memoja dhe Feriti vendosën të sulmonin për t'i çkullur dhe përzënë nga toka shqiptare. Urdhri i komandant Memos u përhap me shpejtësi në gjithë vijën e kufirit. Ushtarët u përgatitën për sulm. I pari u ngrit Memo e pastaj e gjithë kompania u sul e para pas tij. Sulmi i vrullshëm bëri që monarko-fashistët të thyeshin shpejt. Duke lënë të vranë e të plagosur, armiku u tërhoq. Komandant Memo Nexhipi vëmendjen e përqëndroi te

vendosja e luftëtarëve në pozicionet më të përshtatshme të terrenit, ku zjarri i armëve të ishte sa më i efektshëm mbi armikun me sheshpamje dhe me sheshqitje, që përgatitej për sulm. Në mesditën e 2 gushtit monarko-fashistët, të mbështetur nga 15 avionë luftarakë, përsëritën disa herë sulmet. Gjithë Vidohova ishte ndezur flakë dhe ushtarët, me në krye komandant Memo, luftonin heroikisht, duke i vënë detyrë vetes të mos thyeshin, armiku nuk duhej të kalonte kufirin shtetëror. Por një predhë ja mori jetën heroit të Labërisë. Agresioni ushtarak grek i gushtit 1949 ndaj trojeve shqiptare është një njollë e zezë në marrëdhëniet fqinjësore, ku studimi i agresionit ushtarak të 1949 përbën një pjesë të rëndësishme të historisë së Ushtrisë Kombëtare Shqiptare dhe

← të popullit shqiptar, do të jetë gjithmonë pjesë e vëmendjes së historiografisë shqiptare, për të evidentuar Ushtrinë Shqiptare në mbrojtjen territoriale të vendit, për të edukuar brezat me kulturën e domosdoshme të përkujtimit e vlerësimit të luftës dhe të heronjve e dëshmorëve të saj. Dokumentet e kohës tregojnë se gjatë këtyre përlëshjeve në trojet shqiptare mbetën të vrarë mbi 300 ushtarë e oficerë grekë, 500 të plagosur dhe 270 robër dhe nga pala shqiptare ranë 87 kufitarë që janë dëshmorë të Atdheut, midis tyre Heroi i Popullit Memo Nexhipi, u plagosën mbi njëqind ushtarë,

kuadro dhe civilë, u dekoruan me “Urdhërin e Trimërisë”, mbi 180 ushtarë, oficerë e civilë. Ngjarjet në Vidohovë ishin sa të përgjakshme, aq edhe heroike dhe pikërisht për këtë heroizëm posta kufitare e Vidohovës u shpall Postë “Hero i Popullit”, por këtë titull të madh e meritoi edhe heroi i fshatit Dukaj, heroi i Tepelenës, heroi i Labërisë, heroi i Kombit shqiptar. E meritonte prej kohësh një bust heroi ynë dhe ja ku e kemi sot në fshatin e tij të lindjes, në Dukaj, ku i madhi Maliq Lila, i këndonte: “Syri këtu ka ballkonë./Duket pra Dukaj të thotë..”, Ndërsa poezia e ardhur nga Fushbardha enkas për këtë event nga Nexhip Onjea

thotë: “Dukaj në një rrëzë mali./ Gur themeli historia./Dil e prit se të vjen djali./Po vjen në shtëpi të tija./Kapiten Memo Nexhipi, Mbetë yll karvani, Hallall gjiri që të rriti./Lum e lum’ Vatani./ Mirësevjen o biri ynë./Krishtë dyfeku në këngë./Pëllumb i bardhë për lirinë./Gur i rëndë në tokën mëmë./ Çika stralli, xixa syri./Dritë për historinë./ Shenjtëri mbeti kufiri./Ndaj i fale djalërinë./Memo mbeti vepra jote./Këngë zemre amaneti./Mbeti me lavdi mbuluar./Vitet dhe koha se treti...Të ka Labëria djalë, Atdheu pëllumb të bardhë”. Është për tu vlerësuar vendimi i këshillit bashkiak nr.44 datë

30.7.2024 me nr rregj. 1359/5 datë 1.8.2024 e firmosur nga Kryetari Arben Gumeni dhe sekretarja Valbona Çela me 12 vota pro dhe sigurisht e konfirmuar nga pushteti qendror me autoritetin në bazë që është Prefekti Odise Kote, gjithmonë i gatshëm kur bëhet fjalë për çështje të rëndësishme parësore që mbart atdhetari dhe shqiptarizëm. Kjo vërtetoi miratimin ligjërisht të vendosjes së bustit të heroit sipas kërkesave të ligjit por dhe nderimi që i bëri Këshilli i Qarkut Gjirokastër duke e vlerësuar me titullin e lartë “Nderi i Qarkut Gjirokastër”. Propozimi i SHAK “Labëria” e degës së Tiranës kishte

kristalizuar veprimtarinë e heroit: “Për kontribut të shquar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare si luftëtar antifashist, ushtarak trim e guximtar, si dhe pas çlirimit për meritat e tij si ushtarak i vendosur deri në flimurin e jetës përmbrojtjen e Atdheut, gjatë shërbimit për mbrojtjen e kufijve nga shkeljet dhe provokacionet e monarkofashistëve grekë ku është dalluar për trimëri dhe vetëmohim deri sa u vra, duke u bërë shembull qëndrese e frymëzimi për kufitarët e postës së Vidohovës”. Qoftë i përjetshëm kujtimi i heroit dhe dëshmorit Memo Nexhipi! Lavdi në përjetësi!

Izet Çulli – një libër për prof. Pëllumb Karagjozin



Nga: Dr. LAVER M. STROKA

Një numri botimesh me vlerë në letërsi për të rritur dhe fëmijë, në histori të mjekësisë dhe në shtypin mediatik, dr. Izet Çulli nga Progonati i Kurveleshit të Sipërm të Labërisë, sjell para lexuesve një monografi mjaft interesante për “borgjezin” proletar human, profesor Pëllumb Karagjozin. Ai është biri i mjekut të njohur Tahsim Karagozi, që bashkë me kirurgun Vasil Laboviti, hodhën themelet e mjekësisë moderne në Spitalin e famshëm të Gjirokastrës qysh në mesin e viteve ‘30 të shekullit XX.

Duke qenë se i ati i tij merrte pjesë në një shoqëri grumbullimi dhe shitjeje bulmeti “Delja” dhe pijeve alkoolike para Çlirimit me fisin e vet, mjekut të ri e të talentuar duartartë nuk iu nda nofka “borgjez” gjithë jetën nga disa kolegë të tij. Sa i përket strehimit dhe ekonomisë, doktor Pëllumbi ishte proletar si edhe ata, madje në kushte pak më të vështira se pagëzuesit. Ai ka kryer në vazhdimësi shërbim human shembullor ndaj njerëzve dhe përkushtimin ndaj shkencës mjekësore në specialitetin e vet të kirurgjisë kockore


nga afër profesor Pëllumbin dhe e kam admiruar pa masë si edhe shokët e mi për thjeshtësinë proletare, për buzëqeshjen e natyrshme dhe për sjelljen humane aq të kulturuar, që binte në sy qysh në prezantimin e parë. Nuk kishte vuajtës dhe familjarë të tyre që të mos kishte këtë admirim për të, sidomos pas marrjes së një shërbimi cilësor në gjendje të ndryshme deri të skajshme. Kurrë nuk e kam dëgjuar atë që të fliste ashpër me ndonjë të sëmurë apo familjar. Kjo është gjëja e parë që kërkon populli tek një mjek dhe këtë e gjen kur ai është pritës buzëqeshur, të merr përsipër të të zgjidhë problemin pa të sorollatur, pa preferenca të tilla si pushteti

ka patur një busull orientuese tërë jetën. Këtë pasqyrim “të zgjeruar” e ka realizuar mjeshtërisht miku dhe kolegu im, “gjuetari i virtyteve më të mira” për njeriun, mjeku i njohur shpirtqelbar, Izet Çulli.

Kronologjia e jetës në tërësinë e saj jep me vërtetësi të plotë figurën e këtij personaliteti të shquar të mjekësisë dhe veçanërisht të ortopedisë shqiptare, për të cilin nuk ka munguar konsiderata dhe vlerësimi majtas dhe djathtas, brenda (nga populli më shumë) dhe në botë më tepër nga



Izet Çulli



(për atë kohë edhe sot) dhe paraja (në ditët e sotme), sidomos kur suksesi është i nivelit më të lartë bashkëkohor.

Në vitin 2000, në festimin e 50

shkencëtarët e njohur, që kanë shfrytëzuar arritjet e tij për të korrur suksese në profesionin e tyre edhe në vendet më të zhvilluara. Një konsideratë të lartë për të ka ushqyer edhe vetë udhëheqësi shqiptar Enver Hoxha, duke i mundësuar specializimin jashtë shtetit mes vështirësive të krijuara prej kolegëve, që e pagëzonin “borgjez”. Me të drejtë një komunist, kur profesorin e ftoi PD për të kandiduar në zgjedhjet e vitit 1996, i tha: “Nëse të gjithë borgjezët janë si ju, unë po futem në partinë tënde.”

Libri evidenton diçka mjaft të rëndësishme për ta pasur parasysh çdo mjek, sidomos kur emërohet në një zonë të thellë ose në

një qytet të vogël. Shumë aty braktisin librin duke u kthyer në “pathonj”. Mjedisi shoqëror dhe pija mund t’i degradojë shumë shpejt kur nuk kanë parime familjare dhe morale. Profesor Pëllumbi i shpëtoi për mrekulli kësaj fatkeqësie. Ai preferoi librin dhe punën me përkushtim profesional human duke lënë gjurmë në spitalin e qytetit të Krutës duke hapur repartin e kirurgjisë, ku bëri emër të mirë që e ndoqi gjithë jetën.

Vlerat e tij janë rritur pasi familja ka qenë me kulturë dhe e ka mbështetur pa rezerva për të përparuar çdo ditë, duke studiuar literaturë në disa gjuhë të huaja, duke eksperimentuar në kafshë dhe kadavra, për të hulumtuar dhe për t’u shërbyer natë dhe ditë hallexhinjve pa u kursyer. Vetëm me një familje të përkushtuar dhe të shëndetshme mund të arrihen të tilla objektiva në jetë. Pa këshillat e prindërve, pa mbështetjen e bashkëshortes, Evelinës, do të ishte e pamundur të kishim një personalitet kaq të kompletuar si qytetar, si mjek, si studiues të nivelit të lartë ndërkombëtar, si një botues librash mjekësorë dhe si mësimdhënës i admiruar. Leximi i kësaj monografie përfundon me një frymë se është ndërtuar në një stil të thjeshtë telegrafik, por të këndshëm. Këtë e ndjeva vetë kur e lexova dorëshkrimin e librit “Profesor Pëllumb Karagozi – krenaria e ortopedisë shqiptare” për të shkruar një parathënie të shkurtër. Me pasion, me librin pranë dhe punë të pareshtur, arrihet gjithçka në çdo veprimtari njerëzore.

Vlerat e tij janë rritur pasi familja ka qenë me kulturë dhe e ka mbështetur pa rezerva për të përparuar çdo ditë, duke studiuar literaturë në disa gjuhë të huaja, duke eksperimentuar në kafshë dhe kadavra, për të hulumtuar dhe për t’u shërbyer natë dhe ditë hallexhinjve pa u kursyer. Vetëm me një familje të përkushtuar dhe të shëndetshme mund të arrihen të tilla objektiva në jetë.

dhe terapisë mbështetëse. Dashuria për njerëzit që vuajnë e ka bërë shumë herë të vihet në konflikt edhe me kolegët, duke e humbur në “kredibilitetin” në spital, por jo në popull.

Kur isha student e kam njohur

vjetorit të Spitalit Rajonal “Omer Nishani” të Gjirokastrës, profesor Pëllumb Karagozit i mora një intervistë të shkurtër të cilën e kam përfshirë me kënaqësi në librin “Gjirokastra Historiku i Mjekësisë”, ku më përmendi këshillat e të atit, të cilat i

Flet piktori Edmond Kojani: Para viteve 1990 janë vlerësuar pikturat “Nënat dhe gratë që shkojnë ndihmë te partizanët” apo “Ikja e rusëve nga baza e Vlorës”

Veçoj pikturat e Sali Shijakut “Zjarri partizan”, Skënder Kamberit, “Në Vjenë duke parë Skënderbenë”, “Bajram Curri” i Guri Madhit, “Gjyqi i Sinjës” i Vilson Kilicës

Intervistoi: Albert Z. ZHOLI

Me Edmondin kam mëse 10 vjet që njihem dhe vazhdimisht ndjek pikturat e reja që ai sjell nëpër ekspozita kolektive, apo individuale. Një njeri i dashur, që gjithë jetën e ka lidhur me pikturën. Në Vlorë dhe më tej ai njihet si një piktor me vlera. Ai është një ndër piktorët e paktë shqiptar që ka hapur ekspozitë qysh në sistemin socialist. Vlorë i ka dhënë atij aromën e detit për një ideim dhe forcë interpretuese krejt të ndryshme. Plot 17 ekspozita që ka hapur (në Vlorë të parën në vitin 1988) në Vlorë, Greqi, Tiranë, Durrës, Fier, Sarandë, Berat, etj dhe rreth 150 piktura në gjininë e peizazhit përbëjnë arkivin e tij që do ta kishte zili çdo piktor. Por ekspozitën e tij më të bukur për mua e ka hapur në vitin 2017 në Muzeun Kombëtar “Udhëtim në kohë” të cilën dhe ai e quan të veçantë për specifikën e tij. Qëllimi i ekspozitës ishte promovimi dhe sjellja në vëmendje e monumenteve të kulturës dhe siteve arkeologjike si pjesë e trashëgimisë sonë kulturore. Por pas saj Edmondin ka hapur dhe 5 ekspozita të reja me shumë krijime që kanë tërhequr vëmendjen e kritikës.

-Piktura një profesion i bukur, frymëzues dhe shtysë vizionesh, si lindi dëshira për pikturë dhe kush e zbuloi talentin tuaj?

-Fillimet e mia me pikturë janë që në klasë të pestë, kur shkoni në Shtëpinë e Pionierit, ku mësonim vizatim dhe pikturë, me bojra uji (akuael).

-Në shkollë kush ishte mësuesi që ju mbështeti për këtë rrugëtim. Cilat ishin mësimet e tij për ju?

-Në Lice mësim na jepte i ndjeri Skënder Lako dhe Gjergji Marko, ndërsa në Institut të Arteve, Guri Madhi piktorë, dhe Pandi Mele, grafik. Guri të shtynte drejt një pikturë me penelata të ngjeshura në drejtim modelimi dhe pikturim me ngjyrë të plotë. Kurse nga Pandi Mele mësova të kompozoi. Ai të mësoni një kompozim lakonik, ku lexohej menjëherë ajo që deshe të shprehje.

-Kur dhe si konkurruat për pikturë, çfarë ju dhanë për të pikturuar dhe kush ishte në komision? Cili ishte vlerësimi?

- Në Lice konkursi ishte me një pllakë allçi, lulja e njohur trigjethëshe e me një bisht të stërgjatur poshtë. Në Vlorë ishim të përgatitur mirë deri në klasë



Edmond Kojani

të tetë me kurset, që bënim, sa të mos ishte fare problem ai lloj konkursi, kurse në Institut konkursi ishte me një portret vizatim dhe një portret me ngjyra vaji. Dola shumë mirë, pasi kisha punuar mjaft portrete me laps e me vaj duke qenë që dhe dihej që konkurimi bëhej me portret dhe vazhdimisht shkoja tek Skënder Kamberi dhe Agron Dine në Vlorë për konsultime.

-Kur e keni hapur ekspozitën e parë dhe ku? Sa piktura kishit dhe çfarë gjinie ishin pikturat?

- Ekspozitën e parë personale e hapa në vitin 1988, tre vjet pasi kisha mbaruar Institutin e Lartë të Arteve, në Galerinë e Arteve Vlorë., aty ku i thoshnin “Rruga e çifutëve”, godinë e bukur trekatëshe. Ekspozita kishte 40 punime, përgjithësisht peizazhe, ndonjë kompozim me figurë dhe portret. Kisha vënë synim paraprakisht dhe kisha shkuar deri në Lurë për të pikturuar, Tiranë, Sarandë, Qeparo e Gjirokastrë.

-A janë pedagogët e shkollës së pikturës shqiptare të nivelit European? A kishte prirje për të parë piktorët e huaj me famë në sistemin komunist?

- Pedagogët e shkollës sonë kanë qenë shumë të mirë. Mendimi i krijuar, në kohën e qenurit studentë, ka gjetur vërtetësi dhe me kalimin e viteve. Pjesa më e madhe e tyre kishin studiuar jashtë dhe ishin edhe të përkushtuar. Për mua ishte fat që jetoja në Vlorë dhe studio e Skënder Kamberit dhe Agron Dines ishte shkollë e vërtetë. Atëherë kishte shumë frymë pune e diskutimi. Flitej për formën, mjetin artistik për të krijuar vepra arti të mirëfillta. Ka patur një dëshirë, tendencë për të parë autorë të huaj dhe sidomos ata, që ishin të ndaluar. Interesi ishte i natyrshëm se kishte komente që qarkullonin për kulturë e art me elemente

frymë e shprehje ekspresive, si në konceptin e përgjithshëm, ashtu edhe teknikën realizuese.

-A është bërë kulturë mbajtja e një pikturë origjinale në shtëpitë shqiptare? Apo vazhdohet me piktura të kopjuara seriale?

- Mbjaj mend që në Vlorë, që shpejt para viteve '90, kishte dëshirë nga qytetarët të kishin në shtëpitë e tyre një pikturë. Kjo, dhe falë asaj klime krijimtare si në asnjë qytet tjetër. Sot pa diskutim që është bërë kulturë prania e pikturave në shtëpi, zyra, lokale e hotele. Madje janë krijuar koleksione private me piktura nga një numër i madh personash që me pasion grumbullojnë piktura nga artistë të ndryshëm. Madje në Vlorë para disa muajsh është krijuar i pari muze arti privat Muzeu “Selami” në ambientet e Kuzum Babasë.

-Si do ta cilësoni pikturën e realizmit socialist pasi sot ka kritika të ashpra ndaj saj...A ka pasur vlera?

- Piktura e realizmit socialist ka patur vlera të padiskutueshme, i referohem pikturës më të mirë të asaj kohe me vlera piktorike, teknikë e zgjidhje kompozicionale të gjetur. Një profesionist i mirë di t'i dallojë këto. Jashtë veshjeve ideologjike të kohës, ka gjithmonë diçka në art që vjen në kohën tjetër, nuk është vetëm kriteri ideologjik për vlerësim, por bukuria estetike e veprës, forma, akoma dhe elementë të tjerë përbërës të veprës, shoqërorë, etike e morale, që jetojnë natyrshëm në shoqëri të ndryshme. A nuk është e bukur piktura e Sali Shijakut “Zjarri partizan”, “Zëri i masës”, “Mic Sokoli” e sa të tjera. Po Vrana Konti i Skënder Kamberit, “Buka e duarve tona”, “Në Vjenë duke parë Skënderbenë”, e mrekullueshmja “Vajza e valëve”, po kështu Bajram Curri i Guri Madhit, “Dorëzimi i armëve”, “Gjyqi i Sinjës” i Vilson Kilicës e sa e sa vepra të tjera të Ismail Lulanit, Danish Jukniu,

Pandi Meles, Agron Dines, e Nestor Jonuzit apo e Bashkim Ahmetit. Ata që dinin të bënin art, e bënin atë edhe kur futnin në tabllo pushkën apo kazmën.

- Në sistemin komunist a keni pa momente të vështira për mënyrën e pikturës. A keni pikturuar ndonjë ish-udhëheqës komunist dhe a keni takuar ndonjë prej tyre?

- Vetëm një rast kur kam bërë një portret grafik të Enver Hoxhës. Portreti ishte i realizuar nga marrëdhënia e të kuqes dhe të bardhës të fletës dhe pritej poshtë nga jaka. Nuk kishte vazhdim të supeve, por nga ana formale nuk të shqetësonte, nuk krijonte ndonjë mungesë se loja grafike e zgjidhte këtë. Puna u pëlqye dhe u vendos në ekspozitë në Vlorë. Pak para çeljes të ekspozitës, më thërret Skënder Kamberi që e pëlqente shumë dhe më tha që duhet ta hiqim .se kishte vërejtje nga Komiteti Partisë. Arsyeja ishte mungesa e supeve.

- Sa ekspozita ke hapur deri më sot? Vlerësimet...?

- Kam hapur 17 ekspozita. Besoj se janë pritur shumë mirë nga

ekspresionizmi për mënyrën e forcës shprehëse.


-Piktorët janë përdashës pasi i nxit për frymëzim, cila pije është më e preferuara dhe pse?

Besoj se përgjithësisht janë. Mendoj që jo shumë para punës, se sa pas saj. Atëherë pija i ndihmon të qetësojnë impulse emocionale, të mendojnë disi çfarë kanë bërë e çdo të bëjnë.

-Cilat janë problemet e piktorëve shqiptarë sot dhe cilat janë pikturat më të preferuara ato kalsike, apo abstraksioniste?

-Nuk ka një treg të mirëfilltë arti të strukturuar, apo kodifikuar. E kam fjalën për mungesë menaxheri, apo galerie që me kredibilitetin e tyre të krijojnë pak a shumë statute artistësh, kuotim vlerash. Shkohet me opinione kolegësh e deri diku të disa segmenteve me një fare asesi në këtë drejtim. Gjithsesi po krijohen disa koordinata të këtij sistemi, por të orientuar mbase në vektorin e artit postmodernist.

-Portreti, natyra e qetë, peizazhi, kompozimi, cila gjini dominon në pikturat



artdashësit, publiku, kolegët e koleksionistët.

- A mund të jetosh sot me pikturë?

- Edhe munden disa.

-Cilat janë pikturat tuaja më të vlerësuara?

-Ka patur disa, para '90; kompozimi me: “Nënat dhe gratë që shkojnë ndihmë te partizanët” apo “Ikja e rusëve nga baza e Vlorës”. Pas viteve '90 janë pëlqyer peizazhe me det, vjeshtat nga Korça e mjaft të tjera nga Gjirokastra.

-Cilët janë piktorët në botë që ju impresionojnë?

1.Pintoretot për kompozimet dinamike; 2.Goja për frymën piktorike; impresionistët për dritën dhe Plenerin, dhe

e tua, apo më mirë në cilën gjini e gjeni më mirë veten?

Peizazhi dominon si gjini në krijimtarinë time. Aty gjendem në burimin e përhershëm të përjetimit ndjesor.

-Je penduar që je bërë piktor?

-Jo aspak. Do pikturoja sikur dhe një tjetër jetë të kisha, pasi ndjej që kam e dëshiroj të bëj shumë gjëra në pikturë e me pikturën.

-Pikturat tuaja janë në vaj, kjo është teknika-boja që ju preferoni dhe pse?

-Teknika e vajit të jep mundësinë të shprehesh maksimalisht në thellësi e në gjerësi. Me anë të kësaj teknike arrin të thellosh efektin fillestar emocional dhe pasurinë e dëshiruar koloristike.

Familje patriote të Smokthinës që dhanë dëshmorë për Atdhenë



NGA: PROF. ASOC.
BERNARD ZOTAJ

Në luftën e madhe Antifashiste të bërë nga populli shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, shumë familje patriotike të smokthinjotë u rreshtuan në formacione luftarake dhe luftuan me guxim dhe trimëri gjersa dhanë jetë për Atdhe. Gjatë muajit shtator 1944 nga Smokthina ranë në fushën e nderit...

Djali i mësuesit ra dëshmor

Syrja Veliko Sarçaj lindi në Hysaj të Ramicës më 11 shtator 1925. Ai u rrit mes vështirësive, por u edukua me ndjenja patriotike nga halla e tij, Pashako Jaçe e cila ishte një grua kapedane dhe në çdo kohë shtëpia e saj u bë jatak për partizanët. Edhe Syrjai u përfshi në LANÇ-in, që në Vlorë në vitin 1942. Doli partizan në çetën "Zigur Lelo" të Smokthinës dhe mori pjesë në aksionet dhe luftimet e organizuara prej saj. Rreshtohet luftëtar në radhët e BrVS që më 28 nëntor 1943, në Gumenicë të Vlorës dhe mori pjesë në luftimet që zhvilloi brigada. Më 20 shtator 1944 BrVS gjendej në luftime me forcat tradhëtare të zonës së Lumës. Batalionet partizane të saj ishin shpërndarë, në Kolesian batalioni i dytë, ku ishte shtabi i brigadës dhe spitali partizan, ndërsa batalioni i tretë ishte në Nangë dhe Bicaj, ndërsa dy kompani të batalionit të parë gjendeshin në Lusën.

Forcat tradhëtare të zonës kishin zënë pozicione në rajonet zotëruese dhe në orët e para të mëngjesit, kur partizanët dolën nga shtëpitë e fshatarëve lumjanë ku kishin kaluar natën, u grumbulluan në qendër. Këtu u goditën pabesisht nga të gjitha anët. Partizanët ju përgjigjën flakë për flakë goditjes së reaksionit. Në krye të një grupi partizan u vu skuadërkomandanti Hasan Laze Qejvani që kishte përvojë luftarake, pasi ishte një nga partizanët e parë të çetave dhe dallohej për guxim. Skuadra zuri pozicion në një kodër shkëmbore dhe hapi zjarr. Këtu u luftua gjatë dhe me trimëri gjersa gjersa ranë për Atdhe heroikisht partizanët Agjah Selam Dautaj dhe Syrja Veliko Sarçaj... Ishte data 20 shtator 1944 kur në Lusën të Kukësit ra në përpjekje me forcat tradhëtare, partizani dhe djali i vetëm i mësuesit Veliko Sarçaj. Syrja Sarçaj është shpallur Dëshmor i Atdheut me nr. vendimi 97, datë 22.09.1972 të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Vlorë. Varri i tij gjendet në vorrezat e Dëshmorëve në Vlorë. Për dëshmorin në vite është shkruar në revistën "Pavdekësia", në gazetën "Labëria" dhe "Telegraf".

I varfër, por dinjitoz në jetë...

Besim Haxhi Xhaferaj ka lindur në Matogjin të Smokthinës më 1907.

Ishte një familje me të ardhura të pakta ekonomike dhe u detyrua të largohej nga fshati për të siguruar bukën dhe u vendos në Qishbardhë. U rrit duke punuar me djersën e ballit për të mbajtur familjen dhe për të qëndruar me dinjitet. Ndjenjën e revoltës Besimi e tregoi kur nuk pagoi mbitaksën që kërkonte regjimi nga fshatari i varfër. Trimëria e treguar bëri që ai të shihej me simpati e respekt nga bashkfshatarët dhe si një atdhetar që luftonte për të drejtën, si dhe për guximin që e karakterizonte. Okupatori fashist e rëndoi dhe më shumë jetën e Besimit, u ashpërsua dhe më tepër lufta për qëndresë. Me fillimin e Lëvizjes Antifashiste, Besimi e zuri pozicionin e tij, duke u bërë agjitor, guximtar e sypatrembur për sakrificat që kërkonte lufta. Aktivizohet në fillim të vitit 1942 me lëvizjen dhe merr pjesë aktive në formacionet luftarake antifashiste territoriale, në çetën e Qishbardhës dhe në aksionet e bëra prej saj. Më 15 shtator 1943 bie dëshmor në Luftën e Drashovicës kundër okupatorit gjerman. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me nr. vendimi 97, datë 22.09.1972 të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Vlorë.

Bariu me ndjenja të fuqishme atdhetare

Leven Imo Muçaj lindi në vitin 1889 dhe jetoi në fshatin Bashaj të Smokthinës, në një familje të varfër, por me tradita patriotike. Leveni bashkë me të afërmit e tij dhe fshatarë të tjerë, mori pjesë në Luftën e Janinës deri në fund të saj dhe u dallua për guxim e trimëri. Me maunxerrin e fituar në Luftën e Janinës mori pjesë dhe në Luftën e Vlorës më 1920 dhe luftoi përkrah luftëtarëve patriot. Ishte një kundërshtar i vuajtjeve, i mjerimit dhe i regjimit të Zogut, si dhe kundër pushtimit fashist e nazist të vendit. Me fillimin e vitit 1942, Leveni ishte nga të parët që u lidh familjarisht me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. U radhit në çetën territoriale të fshatit që në krijim dhe mori pjesë në luftimet që zhvilloi, si në Luftën e Gjormit, në aksione dhe në Luftën e Drashovicës. Kudo dha përvojë lufte dhe u dallua si trim dhe atdhetar i flakët. Tek bariu i thjeshtë ishin rrënjësor ndjenja të fuqishme atdhetare, të cilat bënë që të ishte një nga luftëtarët më të flaktë në luftën kundër pushtuesve dhe tradhëtarëve. Në ballë të çetës, në luftë për të marrë Urën e Drashovicës, më 15.



9. 1943, ra përmes breshërive të predhave të artilerisë, duke mos kursyer gjakun për Atdhenë. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me nr. vendimi 97, datë 22.09.1972 të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Vlorë.

Xha Musai thirri "Përpara djem e paçi hallall!"

Musa Ramo Hasaramaj lindi në Matogjin të Smokthinës në vitin 1893. Ngeli jetim dhe bashkë me vëllanë, Hekuran, emigron në Turqi. Në shkollën e fshatit Matogjin bëhej mësim turqisht, ai hodhi hapat e

milicisë fashiste dhe mercenarëve. Me çetën e Matogjinit natën e 14-15 shtatorit, Musai zuri rajonin në pjesën veriore të fshatit Mavrovë, ku do të sulmonin në drejtim të bregut jugor të përroit të Sklapit. Musai duke iu afruar qendrës së zjarrit të nazistëve plagoset rëndë. Ai shkoi në luftë mbas të rinjve e në krye të tyre. Ai mbeti aty buzë brigjeve të Shushicës, në luginën e Drashovicës, tek thërriste në ballë të partizanëve "Përpara djem e paçi hallall!" Kënga e popullit për atë betejë thotë:



para në mësimin e gjuhës turke, të cilën e përmirësoi në Turqi, si dhe në Greqi, që ishte në kurbet mësoi dhe greqisht. Shpalljen e Pavarësisë së Atdheut, Musai e priti me gëzim dhe punoi për jehonën e ngjarjes në rrethin e emigrantëve. Për të ruajtur emrin dhe nderin e shqiptarit kur një feudal turk deshi ta poshtëronte, iu përgjigj me të shtënën e revolverit. U dënua

Në luftën e madhe Antifashiste të bërë nga populli shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, shumë familje patriotike të smokthinjotë u rreshtuan në formacione luftarake dhe luftuan me guxim dhe trimëri gjersa dhanë jetë për Atdhe. Gjatë muajit shtator 1944 nga Smokthina ranë në fushën e nderit...

me vdekje, por me ndihmën dhe përkrahjen e emigrantëve shqiptarë në Turqi i shpëtojë dënimit kapital. Doli nga burgu dhe në vitin 1919 kthehet në Atdhe, duke kthyer shtëpinë në një vatër patriotike. Në vitin 1920 rreshtohet në çetën e fshatit Matogjin dhe luftoi kundër pushtuesve italianë në Kotë, në Drashovicë, në Sherishtë, në Qafën e Babicës dhe në luftimet mbi Vlorë. Musai atdhetarin revolucionar Halim

Xhelo e kishte mik shtëpie. Ai mori pjesë si luftëtar në forcat e revolucionit të Qershorit 1924. Pushtimi fashist i vendit e preku thellë dhe u vu në ballë të rezistencës. Por besnikërinë e tij ndaj Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, më 29 nëntor 1942, në Verbas të Smokthinës, zgjidhet anëtar dhe kryetar i këshillit nacionalçlirimtar dhe përgjegjës i njësitit gueril për fshatin Matogjin. Xha Musai si propandist dhe agjitor i flakët i Luftës Antifashiste gjendej në çdo mbledhje, por dhe midis të rinjve me pushkë në krah. Më 31 dhjetor 1942, zgjidhet komandant i çetës territoriale të fshatit Matogjin dhe mori pjesë në Luftën e Gjormit për shpartallimin e

Drashovica atë ditë./ E vu gjermanin në darë./ Me djem e burra petritë./ Hysni Kapua jep komandë./ Si kjo radhë dhe tjetër herë./ Drashovica kish provuar./ Burra që s'u dhimbsej jeta./ Musa Ramo ballë shkruar.

Musai është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me Medaljen e Kujtimit, Urdhërin e Trimërisë, Medaljen e Trimërisë dhe Medaljen e Çlirimit dhe shpallur Dëshmor i Atdheut me nr. vendimi 97, datë 22.09.1972 të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Vlorë.

U rreshtua në çetën e trimave

Selfo Kajtas Llanaj lindi në vitin 1910, në një familje të varfër të fshatit Bashaj. Gjyshi dhe babai kishin qenë të internuar dhe nizamë për vite në kohën e Turqisë. Ai i kaloi vitet e rinisë çoban me bagëtitë e të tjerëve. Banesë për të ishin stani, kasollja dhe vatha e dhënve. Ai mësoi për Luftën e Vlorës të vitit 1920, kur babai dhe vëllai i madh shkuan me Zigur Lelon në çetë e me trimat e Smokthinës për të sumuar në Kotë kundër italianëve. Me këtë urrejtje për armiqte, u përfshi në Luftën Nacionalçlirimtare. Fillimisht ishte nga të parët në njësitin gueril të fshatit dhe anëtar i çetës territoriale. Ai ndodhej gjithnjë në stan, por kur merrte sinjalin e alarmit 5 pushkë dhe një bombë, kapte pushkën, trastën me fishekë dhe bomba, të cilat i mbante në gatishmëri, gjendej në vendin ku mblidhej çeta. Trim i rrallë u tregua në luftimet që zhvilloi çeta në Luftën e Drashovicës 1943 ku luftoi me guxim dhe trimëri... 17 shtatori ishte dita e tretë e luftimeve... pasdite shtatori dielli përvëlonte, por çeta sulmoi pozicionet e gjermanëve në jug të lagjes së sipërme të Drashovicës. Tymin dhe flakën e predhave të monajave e breshërinë e mitralozavë t ë armikut, Selfoja nuk i vinte re, sepse e kishte mëndjen t e

pylli i dëndur përpara, ku ishin struktur disa armiq. Ai sulmoi drejt tyre për t'i azgjësuar, por mundi të hidhte vetëm tre bombat e fundit që kishte në trastë dhe zëri i tij i fuqishëm "Përpara shokë!" u pre nga një breshëri plumbash... Populli e skaliti në këngë: *Selfua i pari sulmoi,/ Shumë armiq për tokë rrëzoi,/ Bombat e fshekët i mbaroi,/ Një breshëri gjoksin ia shpoi.* Është shpallur Dëshmor i Atdheut me nr. vendimi 97, datë 22.09.1972 të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Vlorë.

Komandanti në krye të çetës ishte i pari...

Sulo Imer Derraj lindi në vitin 1907 dhe



jetoi në fshatin Bashaj. Familja e tij merrej me bujqësi. Ai mundi të mësonte dhe dy klasë shkollë. Nisi të punojë qysh në moshë të re në mulli dhe dërstilë, ku mësoi të pastrojë, të shkrirojë e të ngjeshë mirë velenxa e rroba të tjera leshi. Rrobat e shajakut vinin jo vetëm nga fshatarët për rreth, por dhe nga krahina të tjera si Sevasteri etj. Sulo ishte dhe një patriot. Edhe i ri mori pjesë në Luftën e Vlorës të vitit 1920.

Në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare u bë një propagandist, përkrah Qeribasë, Elmazit dhe luftoi... Për aktivitet të

dëndur e besnikëri ndaj ideve për liri, Sulo u zgjodh komandant i çetës territoriale të fshatit Bashaj, duke e komanduar në luftimet si në Luftën e Gjormit më 31 dhjetor 1942 dhe deri në Luftën e Drashovicës në shtator 1943. Në sulmin për goditjen e nazistëve dhe marrjen e Urës së Drashovicës, Sulo ashtu si dhe Zigur Lelo dha jetën në krye të çetës, i pari. U këndua kënga: *Sulo Derri dhe Leven Imo,/ Një hap me xha Musanë,/ Katër trima në një ditë, Mbenë me Selfo Kajtazë.* Është shpallur Dëshmor i Atdheut me nr. vendimi 97, datë 22.09.1972 të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Vlorë.

MIRSEERDHËT NË FTERRËN E BUKUR

PROFIT ZANI, KRYETAR I FSHATIT FTERRË

Tdashur bashkëfshatarë dhe bashkëqytetarë Ftërrjot, të ardhur sot në Ftërrë në këtë takim mbarëfërrjot të brezave.

Të dashur zonja dhe zotërinj, miq dhe të ftuar, dashamirës të Ftërrës dhe të Ftërrjotëve.

Mirëseerdhët në Ftërrë. Jeni kurdoherë të mirëpritur. Pjesmarrja juaj na nderon. na shton kënaqësinë dhe vlerat e këtij takimi tradicional, festiv e miqësor. Oqftë kjo ditë, një ditë e gëzuar nga tërësia e ditëve të gëzuara të jetës tuaj.

Si kryetar i fshatit, si mikpritës dhe si organizator i këtij takimi festiv, ndjehem shumë i vlerësuar dhe i respektuar që mu dha rasti t'ju përshëndes, t'ju uroj mirëseerdhjen dhe t'ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë takim tradicional të shumëpritur nga çdo bashkëfshatar dhe bashkëqytetar Ftërrjot.

Sot Ftërra dhe Ftërrjotët përjetojnë një nga ditët më të mira e më të gëzuara. Kjo ditë e bekuar nga Zoti na obligon dhe na krijon mundësinë të mblidhemi sëbashku në Ftërrë, në vendlindje dhe në fshatin tonë të origjinës, të takohemi, të çmallemi e të urojmë njeritjetrin për ditë më të mira, për shendet e mbarësi, për më shumë solidaritet e begati, në të mirë të komunitetit dhe të fshatit tonë të përbashkët. Kanë ardhur sot në këtë takim, në këtë ceremoni festive, Ftërrjotë nga afër dhe nga larg, nga të gjitha anët e viset e vendit dhe të botës, nga Tirana, Durrësi, Fieri, Vlora, Saranda, nga Greqia, Italia, Gjermania, Amerika, Kanadaja dhe Australia. Prandaj sot në Ftërrë edhe natyra është më e gjallëruar, uji i Izvorit, ngurrëzës, dhe Kroit të Bedrinit ka shtuar sasinë dhe freskinë, perimet dhe frutat e pemëve janë më të pjekura e më të lulëzuara. Shtëpitë më të zbuluara me dyer e dritare të hapura, baballarët dhe nënat fterjote më të lumtur, më të qeshur, e më të gëzuar, sepse presim bijtë dhe bijat e tyre të përmalluar. Të nderuar Zonja dhe Zotërinj, miq dhe të ftuar. Duke ju falënderuar për pjesëmarrjen tuaj, ju garantoj se Ftërra dhe bashkësia Ftërrjote krenohen, mirëpresin dhe respektojnë cilindon që ka e që mban lidhje me Ftërrën, që punon, kontribuon e ndihmon për përparimin e mëtejshëm të fshatit e të Komunitetit Ftërrjot. Duke shprehur mirënjohje për çdo ndihmesë e mbështetje, Ftërra dhe Ftërrjotët, ashtu sikurdoherë, kanë qenë dhe do të jenë të bashkuar në inters të fshatit, gjithmonë mbi parime e kritere transparente, demokratike e shoqërore. Si kryetar i fshatit



FTERRA

dhe si përfaqësues i një brezi më të ri, do punoj e luftoj që kjo ditë e bekuar dhe e gëzuar të përsëritet e festohet pambarim, brez pas brezi, për të ruajtur e pasuruar këtë traditë të mirë e të bukur, të filluar shumë vite e dekada më parë.

Jeta, puna, dhe veprimtaria e brezave, i kanë dhënë Ftërrës dhe Komunitetit Ftërrjot emër, integritet dhe identitet

JASHIK MACI

Faleminderit dhe mirëseerdhët në këtë takim tradicional e festiv të brezave fterjotë.

Ftërra, Fshati ynë i dashur, respektivisht vendlindje, vendbanim dhe origjinë e përbashkët është produkt dhe histori e trashëgimisë, stafetës dhe vazhdimësisë së brezave Ftërrjot, në mënyrën më simbolike, më harmonike e më paqësore. Ne brezat e sotëm ndjehemi krenarë, dhe u jemi mirënjohës brezave të mëparshëm, për jetën, luftën, punën dhe sakrificat e tyre të cilat i kanë dhënë Ftërrës dhe Komunitetit Ftërrjot emër dhe identitet të nderuar dhe të respektuar. Ky takim i organizuar në këtë ditë të kthjellët e të ngrohtë të muajit gusht (17 gusht 2024) dhe në vitin jubilar të 80 (tetëdhjetë) vjetorit të çlirimit të Atdheut, e gjen fshatin dhe Komunitetin Ftërrjot në një situatë dhe realitet të përmirësuar, me lajme dhe zhvillime pozitive. Lajmi më i mirë, dhe më i gëzuar janë vendimet bashkiake për asfaltimin e rrugës Borsh-Ftërrë, ai për rikonstruksionin e ujësjellësit dhe ai për rikualifikimin e vatrës së kulturës. Prevalon ndër to i kërkuari dhe i shumprituri vendimi për rrugën që na duket sikur është "shkuar, firmosur e vulosur

me asfalt", me idenë që s'mund të fshihet nëpër syrtare tavolinash e burokraci zyresh, vendim i cili pas ekzekutimit në terren, do të rigjallërojë jetën ekonomike e sociale të fshatit dhe të bashkësisë Ftërrjote, do të rikthejë shumë nga të larguarit vendas,, do të zgjerojë dhe intensifikojë interesin dhe investimet fterjote në trojet dhe pasuritë e tyre. Shumë shpejt kjo rrugë do të shndërrohet në frekuencë turistike, ndërkohë që burimi i ujit të Izvorit dhe ai i Ngurrëzës do të bëhen stacione qëndrimi dhe pushimi për kalimtarët e shumtë që do të preferojnë me kënaqësi këtë rrugëkalim. Për nga vjetërsia e ndërtimit

Ftërra, respektivisht vendlindje, vendbanim dhe origjinë e përbashkët është produkt dhe histori e trashëgimisë, stafetës dhe vazhdimësisë së brezave Ftërrjot, në mënyrën më simbolike, më harmonike e më paqësore.

dhe e përdorimit plotësisht shekullor, dhe për nga bukuritë natyrore të relievit tokësor që përshkon, k'jo rrugë do të duhej të meritonte statusin "monument kulture" shoqëruar me mbrojtje nga shteti. Por historia nuk konfirmoi asgjë të tillë, përkundrazi trajtimi i saj njohu vetëm përkeqësim. Ishte dhe ende është kontributi vullnetar i fshatit dhe i Bashkësisë Ftërrjote faktori i vetëm që e mban këtë rrugë në parametra dhe standart minimal kalueshmërie, kuptohet të detyruar për të përballuar nevojat dhe kërkesat e tyre të jetesës. Tani duket se gjithçka u tejkalua, dhe koha flet dhe punon vetëm për mirë. Urojmë dhe besojmë në tenderim dhe asfaltim në afate optimale. Me siguri që vitin e ardhshëm Ftërrjotët dhe kushdo tjetër që do të vijë në Ftërrë për punë dhe pushime do të udhëtojnë në rrugë të asfaltuar.

Zhvillime të tjera pozitive gjatë periudhës pesëvjeçare nga takimi i mëparshëm janë; ndërtimi dhe rindërtimi i më shumë se 20 shtëpish, fillimi i përmirësimit urban të qendrës së fshatit, riaktivizimi i segmentit rrugor Ftërrë-Kuç,, rindërtimi i disa simboleve kushtuar luftës, punës, arsimit etj.

Historia e brezave Ftërrjotë është histori e luftës për liri dhe pavarësi, e punës për ndërtim, rindërtim, mirëqënie dhe ekonomi, e librit dhe e penës për kulturë dhe dituri. Kur ka qenë koha për luftë, filluar që me aktin heroik kundër Turqve të patriotës Maro Kondi, e deri në Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare, Ftërrjotët janë dalluar për pjesmarrje, guxim dhe trimëri, duke i atribuar fshatit dhe komunitetit vetëm emër të mirë, fitore dhe lavdi. Kur ka qenë koha për punë, janë dalluar për organizim, vetmohim e disiplinë, duke shënuar nga koha në kohë, përparim ekonomik, dhe emancipim kulturor e shoqëror. Dhe në çdo rend politik e shtetëror, në çdo periudhë e situatë, brezat e rinj Ftërrjotë të etur për shkollë dhe dituri, kanë frekuentuar auditorët arsimorë të mesëm e të lartë, duke fituar dije e kulturë bashkëkohore, për tu rreshtuar në vijim në ballë të punës intelektuale, krijuese, shkencore dhe akademike. Për bashkësinë Ftërrjote, lufta, puna dhe dituria, kanë qenë dhe mbeten kërkesa dhe veprimtari të ndërjegjëshme me efekte përmirësuese politike, ekonomike e shoqërore. Jeta, puna, dhe veprimtaria e brezave, i kanë dhënë Ftërrës dhe Komunitetit Ftërrjot emër, integritet dhe identitet të merituar. Mirënjohja, vlerësimi dhe nderimi maksimal për ta, është obligim për çdo brez pasues, sepse vetëm kështu sigurohet kohezion shoqëror e komunitar, i cili përbën kusht për begati, prosperitet dhe zhvillim të pandërprerë. Por natyrshëm ndodh që gjatë distancave dhe "valëve" kohore, nga brezi në brez, perceptimi dhe qëndrimi mirënjohës, pëson ndryshim, deri edhe shfaqje mohimi, duke cënauar kështu raportet dhe marrëdhëniet reciproke mirënjohëse e miqësore. K'jo s'duhet të ndodhë, s'duhet lejuar dhe s'duhet pranuar. Mirënjohja është vlerë morale që i mban brezat të bashkuar dhe të integruar. Tregues esencial i saj është evidentimi, respektimi dhe përdorimi i vlerave të kaluara në dobi të të sotmes dhe të ardhmes. Bashkësia Ftërrjote me përvojën e vet të gjithanëshme ka provuar dhe provon se gjithçka e mirë e arritur e ka bazën e vet në vazhdimësinë dhe harmoninë e brezave, dhe kështu do të ndodhë sot e mot, në jetë të jetëve, sepse fterjotët krenarë, të ndershëm, punëtorë dhe paqësorë janë mirënjohës dhe besnik ndaj trashëgimisë, besës, traditave dhe zakoneve të mira e të përparuara.

BAXHUL MERKAJ DHE MUZA E TIJ MËNGJJESEVE TEK “EUROPA CAFFE”

Publicisti dhe kritiku i Artit, Baxhul Merka, po i sjell lexuesit një libër të ri, i cili është ndryshe gjithë librave të tjerë që ai ka shkruar, por ndryshe dhe shumë librave të autorëve shqiptarë të këtij zhanri. Duke qenë mes dialogut, bisedës, shqyrtësës estetike-artistike, profilit të tij si studiues dhe kritik i artit dramatik, diku dhe të monografistit, autori po i afron lexuesit dhe të apasionuarve të kësaj letërsie librin “Mëngjeset tek EUROPA CAFFE”.

Duke qenë një libër i larmishëm, brenda të cilit ka njerëz, ngjarje, histori dhe aktualitet, ai ka një tendencë të mrekullueshme, ku pjesën më të madhe të librit e zënë njerëz të elitës intelektuale dhe të kulturës në përgjithësi, të cilët përmes autorit vijnë si një lloj komunikimi, me ç'rast lidhen kohët, retrospektivat dhe perspektivat, komunikohet për artin dhe kulturën, kujtohen kolosë të artit, dramës, regjisorës, këngës, pikturës, flitet për poetë dhe shkrimtarë, në njërën nga kafenetë më të njohura të Tiranës, e cila qëndron në kujtesën e shqiptarëve që nga viti 1920, “Europa Kafe”. Pavarësisht stilit herë bisedor dhe herë narrativ të të shkruarit të tij, libri “Mëngjeset tek Europa Caffé” ka një spektër të gjerë këndvështrimesh. Përmes personazheve të njohura autori Baxhul Merka vazhdon të sjellë detaje interesante nga kinemaja; aktorë të njohur të kinemasë si personazhe të librit në fjalë, tregimet jetësore të tyre përbëjnë ndoshta po kaq larmishmëri sa dhe ata kanë sjellë në të vërtetë përmes roleve të shumtë në teatër dhe kinema. Po kaq gjendje krijojnë refleksionet e shumta të aktorëve për teatrin, ku shumë prej tyre e mbushin librin me episode njerëzore, me përjetime të veçanta, të cilët janë të treguara për herë të parë në këtë libër.

Libri i ri i Baxhul Merka është ndoshta njëri nga librat e tij më të larmishëm, i cili është shkruar si një dialog i artit, artistëve, poetëve, njerëzve të thjeshtë nga gjitha krahinat e vendit me kohën. Libri krijon një refleksion interesant dhe është mjaft komunikues me perceptimin social, me dhe për kulturën shqiptare, kinemanë dhe artet në përgjithësi, pasi çdo personazh i këtij libri thotë diçka për kulturën, artin, kinemanë, artistët dhe kohën. E në këtë këndvështrim, falë dhe prirjes së autorit për të pyetur dhe dialoguar me çdo personazh të tij, kjo ka sjellë një libër të freskët dhe në një gjetje vërtetë origjinale. Larmia e personazheve të librit, të cilët vijnë nga trashëgimia më e mirë e artit dhe kulturës shqiptare, veçmas të teatrit dhe kinemasë, por dhe të tjerë të ditëve të sotme, duke e miksuar galerinë e këtyre personazheve, autori e ka mundësuar më së miri ta përditësojë këtë komunikim, duke i afruar lexuesit një konsideratë të zgjeruar për artin dhe kulturën, pasi libri në



Ese

fjalë i tëri reflekton një kontekst kulturor. Emra të njohur të kulturës dhe artit, që nga Margarita Xhepa, Drita Pelingu, Irini Qirjako, Timo Flloko, Ndriçim Xhepa, Mevlan Shanaj, Bujar Asqeriu, Fatos Haxhiraj, Luftar Paja, Birçe Hasko, poetët Xhevahir Spahiu e Sadie Kryeziu, piktorët: Skënder Kamberi, Nestor Jonuzi, Ndini Bardhi dhe Agron Dine, regjisorët si

Libri më i ri i Baxhul Merka është një frymë bashkëkohore e komunikimit të kësaj natyre. Artistë, poetë, shkrimtarë, njerëz të njohur dhe njerëz të thjeshtë, piktorë, regjisorë, këngëtarë, profesorë dhe të rinj gjejnë veten nëpër faqet e librit “Mëngjeset tek Europa Kafe”, ku hapësirat e kaltra të shpirtit të autorit, rrahin krahët si pulëbardhat mbi brigjet e Vlorës.

Mihallaq Luarasi, sociologun Gëzim Tushi, regjisorë të filmit si Ylli Pepo dhe Esat Musliu, muzikantë e këngëtarë si Zhani Ciko e Irini Qirjako, intelektualë si: Ago Nezha, Neki Dredha, Albert Zholi, Fitim Çausi, dhe ndonjë artist të huaj, të cilët vazhdojnë të jenë aktivë në jetën kulturore të vendit, mendoj se përbëjnë një frymëmarrje të madhe në librin e ri të Baxhul Merka, të titulluar “Mëngjeset tek Europa Kafe”. Autori ka sjellë një refleksion të madh në kontaktet me persona të tillë, duke vazhduar një përvojë të njohur të tij, siç ka bërë me “kastën” e artit të artit, skenës dhe filmit shqiptar dhe më parë. Duke qenë një njohës i mirë i fushës, një prozator i prirë për të sjellë karaktere njerëzore dhe një poet i natyrës lirike dhe i dashurisë. Publicistika e tij e afron artin me njeriun, duke e bërë atë më jetësor, më komunikues dhe më shprehës. Baxhul Merka në gjithë komunikimin me personazhet e librit,

natyrisht përmes një raporti personal të tij, e shqetëson arti, kultura, kinemaja dhe kultura e librit. Ky shqetësim e bën librin shprehje të komunikimit me kohën. Baxhul Merka ka shkruar që në rininë e tij në shtypin e kohës, gjë që po e bën dhe sot; ai ka shkruar libra interesantë, veçmas ai për personalitetet e artit, kinemasë e ndonjë zhanri tjetër, dhe si i tillë, shqetësimi për



Baxhul Merka

librin, si burim i nevojshëm për popujt e kulturuar, vazhdon të mbetet një çështje dhe sfidë kulturore.

Duke qenë një përzierje mes bisedës, e cila është e pranishme me të gjithë personazhet e librit, një praktikë e rëndësishme në punën e gazetarit të kulturës nga Baxhul Merka për një kohë të gjatë, vlerësimeve që ai ka për bashkëbiseduesit e tij, pjesa më e madhe e të cilëve janë njerëz të njohur të teatrit, kinemasë dhe arteve figurative, duke zbuluar vlerësimet dhe qëndrimet specifkisht profesionale të tyre për aspekte të shumta të këtyre fushave, libri në fjalë komunikon dhe reflekton ide dhe vlerësime në çdo detaj të tij. Njëherësh autori pyet, vlerëson dhe vjelë konsiderata, mendime dhe ide për librat e tij, artin dhe kulturën, një praktikë e njohur nga çdo autor, të cilat ai i shfrytëzon për të reflektuar ide të reja, për të plotësuar gjëra që nuk i ka thënë më parë. Merka e njeh mirë kulturën dhe artin e dramës, të kinemasë dhe artin e aktorit. Ai njeh mirë pikturën dhe konceptet e hapësirës dhe ngjyrës, muzën poetike të poetëve të Veriut e të Jugut. Në vazhdim të koncepteve që përshkojnë librat e kësaj natyre, Baxhul Merka, në pjesën më të mirë të personazheve të këtyre fushave, reflekton gjetje dhe koncepte tradicionale dhe bashkëkohore, duke i shtuar librit të tij elementë profesional krahas natyrës publicistike, mbi të cilin është ndërtuar libri “Mëngjeset tek Europa Kafe”. Në këtë publicistikë dhe eseistike të autorit, vihet re tendenca për t'i zbërthyer karakteret

aktoriale tek Aleksandër Moisiu (vërtetë një njohës i mirë i jetës dhe staturës së tij aktoriale), aktores me përmasa europiane Margarita Xhepa, të aktorit tipik karakterial Timo Flloko, Birçe Hasko, Ndriçim Xhepa, Bexhet Nelku, Prokop Mima dhe ndonjë tjetër, zbulesat interesante dhe njohëse mbi pikturat e Skënder Kamberit, Nestor Jonuzit, Agron Dines e ndonjë tjetër, të cilët përçojnë individualitete të pikturës dhe vizatimit, të peizazhit dhe portretit. Po ashtu, në eseistiken e tij spikatit refleksionet mbi raportet e basorelieveve apo skulpturave me hapësirën tek Odhise Paskali apo Kristaq Rama, përmes vizioneve të të cilëve sot komunikojnë me kohët veprat e tyre skulpturale në sheshet më të njohura të vendit. Këto veçori krijojnë në këtë libër vlera të rëndësishme, për të cilat Baxhul Merka ka studiuar dhe punuar gjithë jetën.

Libri i Baxhul Merka ka misteret dhe befasitë e veta. Ai është një libër i larmishëm, por dhe i natyrës publicistike, i cili ndjell lexuesin për ta zbuluar, por ajo që nuk mund të harrohet lidhet me marrëdhëniet e ngrohta, me kujdesin dhe një lloj malli që ai ushqen për vendlindjen, Lapardhanë, për Vlorën, Labërinë, vitet e jetës që kaloi në vendlindje, njerëzit, kujtesa për prindërit, familjen, aty ku u zgjuan ëndrrat e para për artin e skenës dhe dramën, ku u derdhën vargjet e para poetike dhe meditimit prej artisti. Pjesa më e madhe e këtyre përjetimeve vjen përmes dialogëve e monologëve me njerëzit e këtyre anëve, të cilët partnerizojnë kujtesën dhe meditimet e tij. Këto gjendje meditative i përshkon një fllad gati fëmijëror, pasi fëmijëria mbetet gjithmonë brenda njeriut. Merka e prek tashmë ajo botë e virgjër, e cila herë i vjen përmes njerëzve, herë i vjen përmes këngës polifonike të Lapardhasë e Labërisë, herë i vjen përmes konteksteve bashkëkohore të trendit kulturor të zhvillimit të vendit. Ai nuk i harron lapardhiotët, ashtu siç nuk e harrojnë ata Baxhulin, e ndërsa libri publicistik “Mëngjeset tek Europa Kafe” ka një refleksion të gjerë komunikimit, në të ka shumë Lapardha, Vlorë, bregdet dhe njerëz të thjeshtë të anëve të tij, duke e bërë këtë libër dhe një ese të shkëlqyer për vendlindjen dhe njerëzit. Libri më i ri i Baxhul Merka është një frymë bashkëkohore e komunikimit të kësaj natyre. Artistë, poetë, shkrimtarë, njerëz të njohur dhe njerëz të thjeshtë, piktorë, regjisorë, këngëtarë, profesorë dhe të rinj gjejnë veten nëpër faqet e librit “Mëngjeset tek Europa Kafe”, ku hapësirat e kaltra të shpirtit të autorit, rrahin krahët si pulëbardhat mbi brigjet e Vlorës.

Elegji

Fillim gushti zuri bare
Zemrave helm kullon
Mbledhur sot ne nje vjetor
Syri, Fadilin kerkon

Hap nje sy e nis nje fjale
Nen barin qe e lan vesa
Te presin vajzat ne shkalle
Gruaja, niper e mbesa

SYRI FADILIN KËRKON

(Në përvjetorin e vdekjes së Fadil Canaj)



Fadil Canaj

Qysh e mba balten mbi supe
Ti skishe moshe per te ikur
Cte nxitoi, bere tutje
Dhimbjen le, nje det te kripur

Zemren si behar Miresi
Drejtuar per policin

Aq karat sa ka floriri
Diell, per vellazerine

O burri qe te njeh sheshi
Goja-mjalte e drite-syri
Qielli lart ty te desh
Ne apel ne yjet te thirrri

Llafi qe peshove rende
C'pate me te mire e dhe
Mbetet si lis ne kembe
Ne Canaj, grur per qoshe.